



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI"
VLORE
ZYRA PROTOKOLL-ARKIVËS
Nr. 82117 Prot.
Datë: 14.01.2020

Nr. _____ Prot.

Vlorë, më 09.01.2020

VENDIM

Nr. 17, datë 9.01.2020

PËR

MIRATIMIN E RREGULLOREVE TË PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË: "MASTER PROFESIONAL NË MËSUESI PËR CIKLIN E LARTË TË ARSIMIT BAZË NË LËNDËN GJUHË ANGLEZE", "MASTER PROFESIONAL NË MËSUESI PËR CIKLIN E LARTË TË ARSIMIT BAZË NË LËNDËN GJUHË ITALIANE"

Mbështetur në shkronjën d të pikës 1 në nenin 38 në ligjin Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", shkronjën dh të pikës 1 në nenin 19 në Statutin e UV-së, Senati Akademik në mbledhjen e datës 9.01.2020


VENDOSI:

1. Të miratojë rregulloren e programit të studimit të ciklit të dytë "Master profesional në mësuesi për ciklin e lartë të arsimit bazë në lëndën gjuhë angleze" (bashkëlidhur).
2. Të miratojë rregulloren e programit të studimit të ciklit të dytë "Master profesional në mësuesi për ciklin e lartë të arsimit bazë në lëndën gjuhë italiane" (bashkëlidhur).

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Roland ZISI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK**

**RREGULLORE E PROGRAMIT TË STUDIMIT
"MASTER PROFESIONAL NË MËSUESI PËR CIKLIN E LARTË TË ARSIMIT BAZË NË
LËNDËN GJUHË ANGLEZE"**

Kjo rregullore është hartuar mbështetur dhe në zbatim të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", si dhe në udhëzimin nr. 41, datë 24.1.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", Statutin dhe Rregulloren e Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë.

Neni 1

Emërtimi dhe statusi i programit

1. Programi i studimit "Master profesional në mësuesi për ciklin e lartë të arsimit bazë në lëndën gjuhë angleze" ofrohet nga Departamenti i Gjuhëve të Huaja, Fakulteti i Shkencave Humane, në koordinim të veprimtarive formuese, edhe me njësitë e tjera të këtij fakulteti dhe të Fakultetit të Shkencave Teknike. Ky program studimi është program i ciklit të dytë, "Master", i cili ofrohet në dy vite akademik, në përfundim të të cilit studenti grumbullon 120 kredite (ECTs) dhe merr diplomën: "Master profesional në mësuesi për ciklin e lartë të arsimit bazë në lëndën gjuhë angleze".
2. Përveç njësive bazë dhe kryesore, programi do të realizohet edhe me mbështetjen e entiteve shtetërore dhe private që kanë nevojë për personel administrativ të kualifikuar dhe të pajisur me shprehitë përkatëse.

Neni 2

Objektivat formues të programit

1. Ky program synon përgatitjen e specialistëve në mësimdhënie, mësimnxënie, vlerësim, përgatitje gjuhësore dhe komunikative të nxënësve për testime kombëtare dhe ndërkombëtare, situata të ndryshme pune e shkollimi në gjuhën angleze të pajisur me:
 - a. njohuri të përgjithshme në shkencat filologjike;
 - b. formim të plotë psiko-pedagogjik;
 - c. formim profesional, të plotë e bashkëkohor në metodikën e didaktikën e gjuhës së huaj;
 - d. aftësi për të komunikuar në dy gjuhë të huaja (anglisht dhe italisht/frëngjisht/spanjisht/gjermanisht) në mjedis pune dhe situata komunikimi;
 - e. njohuri të plota teorike në lidhje me strukturën dhe funksionimin e gjuhëve të studimit (anglisht dhe italisht/frëngjisht/spanjisht/gjermanisht);
 - f. njohuri përreth kulturës së vendeve gjuhën e së cilës studjojnë;
 - g. aftësi për të ndërtuar marrëdhënie komunikimi dhe pune në një mjedis ndërkulturor në institucione që bashkëpunojnë dhe ndërveprojnë me partnerë dhe bashkëpunëtorë që u përkasin kulturave të ndryshme.
 - h. aftësi për mësimdhënie, vlerësim, përgatitje gjuhësore dhe komunikative të nxënësve për testime kombëtare dhe ndërkombëtare;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

- i. aftësi për të kuptuar sistemet gjuhësore, proceset e përvetësimit të gjuhës së huaj, politikat vendase dhe evropiane për gjuhën;
- j. njohuri të plota rreth kontaktit evropian të të mësuarit dhe të nxëniet e gjuhës së huaj, çështjeve si plurilinguizmi, multilinguizmi, ndërkulturalizmi dhe sesi qasen këto nga një perspektivë evropiane;
- k. ndjesi të formuar për qytetari evropiane me qëllim për ta vënë këtë në shërbim të formimit të brezave të rinj.
- l. aftësi për të kryer kërkim në fushën e studimit të kryer.

Neni 3

Disiplinat dhe veprimtaritë formuese të programit sipas krediteve

1. Kurrikula e programit të studimit "Master profesional në mësuesi për ciklin e lartë të arsimit bazë në lëndën gjuhë angleze" organizohet në:
 - a. Lëndë bazë;
 - b. Lëndë karakterizuese;
 - c. Lëndë ndërdisiplinore/ integruese;
 - d. Lëndë plotësuese;
 - e. Detyrime përmbyllëse.
2. Kurset/lëndët në program dallohen nga emërtimi, kodi dhe numri i krediteve. Kodi përcakton këta elemente: gjuhën në të cilën zhvillohet kursi ose fushën e studimit të cilës i përket dhe vitin e studimit në të cilin ofrohet. Kështu, kurset/lëndët me kode "ENG ..." zhvillohen në gjuhën angleze, me "ITA ..." në gjuhën italiane, me "ALB ..." në gjuhën shqipe, me "FRE ..." në gjuhën frënge, me "SPA ..." në gjuhën spanjolle, me "CS..." ofrohen nga Departamenti i Informatikës.
3. Përmbajtja tematike e kurseve, të dhënat mbi kursin, mënyrën e vlerësimit, kontrollit të dijes, literatura e detyruar et. paraqiten në *syllabus*-et përkatëse të çdo lënde dhe shpallen në fillim të semestrit nga pedagogu përkatës.
4. Më poshtë paraqitet lista e disiplinave dhe veprimtaritë formuese të programit të shprehura të ndara në kredite për disiplinë dhe tipin e komponentit mësimor si vijon:

A. Lëndë bazë – 12 kredite

ENG 441 Bazat kulturore të edukimit (për gjuhën angleze)	4 kredite
ENG 442 Metodat e mësimdhënies	8 kredite (4+4)
Moduli 1: ENG 442-1 Vështrim historik i metodave të mësimdhënies	4 kredite
Moduli 2: ENG 442-2 Metodat bashkëkohore të mësimdhënies	4 kredite

Lëndë karakterizuese – 44 kredite

ENG 440 Bazat pedagogjike të edukimit	8 kredite (4+4)
Moduli 1: ENG 440-1 Bazat e pedagogjisë	4 kredite
Moduli 2: ENG 440-1 Pedagogjia e gjuhës së huaj/dytë	4 kredite
PSI 450 Bazat psikologjike të edukimit	8 kredite (4+4)





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK**

<i>Moduli 1:</i> PSI 450-1 Bazat psikologjike të edukimit 1	4 kredite
<i>Moduli 2:</i> PSI 450-1 Bazat psikologjike të edukimit 2	4 kredite
ENG 454 Kulturë dhe qytetërim i vendeve anglofone	4 kredite
ENG 453 Komunikim ndërkulturor	4 kredite
ENG 470 Kërkim në edukim	8 kredite (4+4)
<i>Moduli 1:</i> ENG 470-1 Metodën e kërkimit	4 kredite
<i>Moduli 2:</i> ENG 470-2 Shkrim propozimesh dhe raportesh kërkimore	4 kredite
ENG 455 Didaktikë e gjuhës angleze	8 kredite (4+4)
<i>Moduli 1:</i> ENG 455-1 Didaktikë e gjuhës angleze	4 kredite
<i>Moduli 2:</i> ENG 455-2 Qasje profesionale ndaj didaktikës së gjuhës angleze	4 kredite
ENG 456 Didaktikë e letërsisë dhe kulturës	4 kredite

Lëndë ndërdisiplinore/ integruese – 37 kredite

ENG 450 Psikolinguistikë dhe përvetësim i gjuhës së dytë	6 kredite (3+3)
<i>Moduli 1:</i> ENG 450-1 Psikolinguistikë	3 kredite
<i>Moduli 2:</i> ENG 450-2 Përvetësim i gjuhës së dytë	3 kredite
ENG 458 Sociolinguistikë	3 kredite
ENG 461 Linguistikë e aplikuar	3 kredite
ENG 462 TIK në mësimdhënien e gjuhës së huaj	3 kredite
ENG 463 Mësimdhënie e gjuhës së huaj në/për kontekste evropiane	6 kredite
<i>Moduli 1:</i> ENG 463-1 Politikën evropiane për gjuhën	1.5 kredite
<i>Moduli 2:</i> ENG 463-2 Kuadri evropian i kompetencave gjuhësore	2 kredite
<i>Moduli 3:</i> ENG 463-3 Ndërkulturalizmi, multilinguizmi dhe plurilinguizmi	2.5 kredite

Zgjidh një nga:

ITA 431 Italisht/FRE 431 Frëngjisht/GER 431 Gjermanisht/SPA 431 Spanjisht

Moduli 1: ITA 431-1 Italisht (B2)/FRE 431-1 Frëngjisht (B2)//GER 431-1 Gjermanisht (B2)//SPA 431-1 Spanjisht (B2)
Moduli 2: ITA 431-2 Italisht (C1)/FRE 431-2 Frëngjisht (C1)//GER 431-2 Gjermanisht (C1)//SPA 431-2 Spanjisht (C1)





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

Zgjidh një nga:

8 kredite (4+4)

ITAE 454 Kulturë dhe qytetërim italian/FRE 454 Kulturë dhe qytetërim francez/GER 454 Kulturë dhe qytetërim gjerman/SPA 454 Kulturë dhe qytetërim spanjoll 4 kredite

Moduli 1: ITAE 454-1 Kulturë italiane/ FRE 454-1 Kulturë frënge/GER-1 454 Kulturë gjermane/SPA 454-1 Kulturë spanjolle
Moduli 2: ITAE 454-2 Qytetërim italian/ FRE 454-2 Qytetërim francez/GER-2 454 Qytetërim gjerman/SPA 454-2 Qytetërim spanjoll 4 kredite

Lëndë plotësuese – 12 kredite

CSE 446 Komunikim dhe teknologji e informacionit në edukim 3 kredite

ENG 490 Praktikë profesionale 9 kredite

Detyrime përmbyllëse – 15 kredite

ENG 489 Provim përfundimtar/Punim diplome 15 kredite

Shënim: Lënda konsiderohet e shlyer nëse të gjitha modulet kanë nota kaluese.

Neni 4
Plani mësimor

1. Më poshtë paraqitet plani mësimor i studimit, i detajuar me semestra, me disiplinat dhe veprimtaritë formuese përkatëse të programit të shprehura të ndara në kredite, orë mësimore në auditor dhe jashtë auditorit për disiplinë si vijon:

Plani mësimor "Master Profesional në mesimdhënie për CLAB në gjuhë angleze"

Viti	Semestri	Kodi	Lënda	Kredite	Tot. orë / semestër brenda & jashtë auditorit	Tot. orë / semestër në auditorit	Totali orë / jashtë në auditorit		Totali orë jashtë auditorit
							lex	sem	Detyra
Viti	Semestri I	ENG 440/(ENG 440-1)	Bazat pedagogjike të edukimit/Moduli 1: Bazat e pedagogjisë	4	100	45	2	1	55
		ENG 440/(ENG 440-2)	Bazat pedagogjike të edukimit/Moduli 2: Pedagogjia e gjuhës së huaj/dytë	4	100	45	2	1	55
		PSI 450/(PSI 450-1)	Bazat psikologjike të edukimit/Moduli 1: Bazat psikologjike të edukimit 1	4	100	45	2	1	55
		PSI 450/(PSI 450-2)	Bazat psikologjike të edukimit/Moduli 2: Bazat psikologjike të edukimit 2	4	100	45	2	1	55
		ENG 442/(ENG 442-1)	Metodat e mesimdhënies/ Moduli 1: Vështrim historik i metodave të mesimdhënies	4	100	45	2	1	55



REPUBLIKA E SHQIPËRISE

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

	ENG 458	Sociolinguistike	3	75	45	2	1	30
	ENG 461	Linguistike e aplikuar	3	75	45	2	1	30
	Zgjidh një nga: ITA 431/(ITA 431-1) FRE 431/(FRE 431-1) GER 431/(GER 431-1) SPA 431/(SPA 431-1)	Zgjidh një nga: Italisht/Moduli 1: Italisht 1 (B2) Frëngjisht/Moduli 1: Frëngjisht 1 (B2) Gjermanisht/Moduli 1: Gjermanisht 1 (B2) Spanjisht/Moduli 1: Spanjisht 1 (B2)	4	100	45	1	2	55
	TOTALI		30	750	360	15	9	390
Semestri 2	ENG 441	Bazat kulturore të edukimit	4	100	45	2	1	55
	ENG 454	Kulturë dhe qytetërim i vendeve anglofone	4	100	45	2	1	55
	ENG 442/(ENG 442-2)	Metodat e mësimdhënies/ Moduli 2: Metodat bashkëkohore të mësimdhënies	4	100	45	2	1	55
	ENG 450/(ENG 450-1)	Psikolinguistike dhe përvetësim i gjuhës së dytë/Moduli 1: Psikolinguistike	3	75	45	2	1	30
	ENG 450/(ENG 450-2)	Psikolinguistike dhe përvetësim i gjuhës së dytë/Moduli 2: Përvetësim i gjuhës së dytë	3	75	45	2	1	30
	Zgjidh një nga: ITA 431/(ITA 431-2) FRE 431/(FRE 431-2) GER 431/(GER 431-2) SPA 431/(SPA 431-2)	Zgjidh një nga: Italisht/Moduli 1: Italisht 2 (C1) Frëngjisht/Moduli 1: Frëngjisht 2 (C1) Gjermanisht/Moduli 1: Gjermanisht 2 (C1) Spanjisht/Moduli 1: Spanjisht 2 (C1)	4	100	45	1	2	55
	Zgjidh një nga: ITAE 454 /(ITAE 454 -1) FRE 454 /(FRE 454 -1) GER 454/(GER 454 -1) SPA 454/(SPA 454 -1)	Zgjidh një nga: Kulturë dhe qytetërim italian/Moduli 1: Kulturë italiane Kulturë dhe qytetërim francez/Moduli 1: Kulturë frenge Kulturë dhe qytetërim gjerman/Moduli 1: Kulturë gjermane Kulturë dhe qytetërim spanjoll /Moduli 1: Kulturë spanjolle	4	100	45	1	2	55
	Zgjidh një nga: ITAE 454/(ITAE 454-2) FRE 454/(FRE 454-2) GER 454/(GER 454-2) SPA 454/(SPA 454-2)	Zgjidh një nga: Kulturë dhe qytetërim italian/Moduli 2: Qytetërim italian Kulturë dhe qytetërim francez/Moduli 2: Qytetërim francez Kulturë dhe qytetërim gjerman/Moduli 2: Qytetërim gjerman Kulturë dhe qytetërim spanjoll/Moduli 2: Qytetërim spanjoll	4	100	45	1	2	55
	TOTALI		30	750	360	13	11	390
Viti 2 Semestri 3	ENG 455/(ENG 455-1)	Didaktikë e gjuhës angleze/Moduli 1: Didaktikë e gjuhës angleze 1	4	100	45	2	1	55
	ENG 455/(ENG 455-2)	Didaktikë e gjuhës angleze/Moduli 2: Qasje profesionale ndaj didaktikës së gjuhës angleze	4	100	45	2	1	55
	ENG 456	Didaktikë e letërsisë dhe kulturës	4	100	45	2	1	55
	ENG 453	Komunikim ndërkulturor	4	100	45	2	1	55
	ENG 470/(ENG 470-1)	Kërkim në edukim/ Moduli 1: Metodat e kërkimit	4	100	45	2	1	55
	ENG 470/(ENG 470-2)	Kërkim në edukim/ Moduli 2: Shkrim propozimesh dhe raportesh kërkimore	4	100	45	1	2	55
	ENG 463/(ENG 463-1)	Mësimdhënie e gjuhës së huaj në/për kontekste evropiane/Moduli 1: Politikat evropiane për gjuhën	4.5	150	60	0	4	90
	ENG 463/(ENG 463-2)	Mësimdhënie e gjuhës së huaj në/për kontekste evropiane/Moduli 2: Kuadri evropian i kompetencave gjuhësore	2					
	ENG 463/(ENG 463-3)	Mësimdhënie e gjuhës së huaj në/për kontekste evropiane/Moduli 3: Kurikulat evropiane të gjuhës	2.5					



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

	463-3)	evropiane/Moduli 3: Nderkulturalizmi, multilinguizmi dhe plurilinguizmi						
	TOTALI		30	750	330	11	11	420
Semestri 4	CSE 446	Komunikim dhe teknologji e informacionit në edukim	3	75	30	1	1	45
	ENG 462	TIK në mësimdhënie e gjuhës së huaj	3	75	30	1	1	45
	ENG 490	Praktike profesionale	9	225	0	0	0	225
	ENG 499	Provim përfundimtar/Punim diplome	15	375	0	0	0	375
	TOTALI		30	750	60	2	2	690

Neni 5

Përshkrimi i disiplineve që ngërthen programi

1. Ky program studimi ngërthen këto disiplina dhe detyrime akademike, përshkrimet e të cilave paraqiten si vijon:

- CSE 446-Komunikim dhe teknologji e informacionit në edukim- Ngarkesa:** 3 kredite, 1 leksion dhe 1 seminar në javë .Në këtë kurs synohet të jepen njohuri mbi teknologjitë e informacionit dhe të komunikimit në mësimdhënie në mënyrë që studentët të fitojnë njohje dhe kompetena përdorimi të TIK në procesin mësimor për ta bërë atë sa më efektiv. Lënda do të synojë në mënyrë specifike të aftësojë studentin që të integrojë mjetet kryesore që ofron TIK në orën e mësimi. Ky kurs ka për qëllim të pajisë studentët me njohuri mbi kompjuterat, pjesët përbërëse dhe paisjet periferike të kompjuterave, llojet e lidhjeve të kompjuterave në rrjet. Gjithashtu ky kurs ka si qëllim të pajisë studentët me njohuri të avancuara në përdorimin e programeve bazë të domosdoshme në mësimdhënie, të njohurive në përdorimin e internetit, gjuhëve të programimit dhe algoritmeve të thjeshtë.
- ENG 440 Bazat pedagogjike të edukimit (moduli 1: Bazat e pedagogjisë; moduli 2: Pedagogjia e gjuhës së huaj/dytë) . Ngarkesa:** 4 kredite për modul, 8 kredite. Ky kurs ofron një kualifikim të përgjithshëm në fushën e pedagogjisë e mësimdhënies për studentët e masterit profesional me drejtim mësuesinë, pasi nuk është asnjëherë e mjaftueshme nxënica deri në skajet limite të arsimit. Ky program përfshinë, në thelb, mësimdhënie dhe mësimnxënien por edhe promovimin e studentit tashmë të mirë integruar të aftë për të marrë një rol të përgjegjshëm, aktiv në shoqëri. Me një qëllim të tillë në mendje, individ mund të arrijë më shumë informacion, më shumë nxënie duke u fokusuar e përzgjedhur një analizë psikologjike të objektivave në rritjen e aftësive intelektuale dhe njohuritë sociale (mbi baze njohje), mësimin e shkathtësive praktike aktive (të mësuarit psikomotorike), dhe zhvillimin e ndjenjave, qëndrimit, vlerat dhe të mësuarit (emocional e praktik). Përvetësimi i diturisë përfshin të kuptuarin e informacioneve të reja. Aftësitë-Ndërtimin e strategjive mbi fokusin për të mësuar një aftësi të re të veçantë për të përmirësuar rritjen profesionale. Kjo është zakonisht e realizueshme edhe përmes programeve praktike.
- ENG 441-Bazat kulturore të edukimit. Ngarkesa:** 4 kredite, 2 leksione dhe 1 seminar në javë . Qëllimi kryesor i kursit ENG 441 'Bazat Kulturore të Edukimit' është që t'i ofrojë studentëve të gjuhës angleze në ciklin e dytë të studimeve universitare njohuri të përgjithshme në lidhje me aspektet kulturore si dhe zbatimin e tyre në fushën e arsimit, kryesisht atij nëntëvjeçar. Kursi ofron jo vetëm trajtime teorike, por edhe shembuj konkret të aspekteve kulturore në fushën e arsimit të brezit të ri. Studentët do të mund të dëshmojnë vlerësim për çështjet kulturore që shfaqen në praktikën arsimore, të artikulojnë pyetje gjenerative për



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

origjinën dhe pasojat e zgjedheve edukative, të reflektojnë rreth impaktit të lidhjes midis bazave të kulturës dhe praktikës arsimore të asaj kulture teksa përpiqen të krijojnë një mjedis ku mund të mësojnë.

- d. **ENG 442- Metodatat e mësimdhënies Moduli 1:** Vështrim historik i metodave të mësimdhënies /**Moduli 2:** Metodatat bashkëkohore të mësimdhënies. **Ngarkesa:** 8 kredite (4 kredite për modul), 2 leksione dhe 1 seminar në javë. Ky kurs ka për qëllim të pajisë studentët me njohuri për zhvillimin e metodologjive të mësimdhënies të gjuhës angleze. Ky kurs do të diskutojë, analizojë dhe praktikojë një shumëllojshmëri të metodologjive të mësimdhënies të gjuhës në mënyrë që të përgatisë studentët për mësimdhënien e gjuhës angleze duke nisur nga metoda gramatikore e deri tek qasja komunikative. Ky kurs gjithashtu do të sigurojë modelet e nevojshme për zhvillimin e mësimi mbi planet mësimore që t'i aftësojë në praktikën e mësimdhënies. Studentët do të pajisen me njohuri mbi metodat, teknikat dhe strategjitë e ndryshme mësimore. Ata do të kuptojnë se ka shumë teknika që mund të integrohen në mësimdhënien e tyre duke bërë të mundur që ata shprehin besimet dhe mendimet e tyre mbi mësimdhënien dhe të nxënit. Ata do të jenë në gjendje të reflektojnë mbi përvojat e tyre dhe t'i krahasojnë ato me metodologjitë e diskutuara në klasë duke praktikuar njohuritë që do të marrin në teori me anë të simulimeve të orëve mësimore në gjuhën angleze. Studentët do të jenë në gjendje të bëjnë vendimarrjet mbi mësimdhënien efektive duke u bazuar mbi parimet dhe teknikat e mësuara në klasë. Në fund të këtij kursi studentët do të jenë në gjendje të zbatojnë parimet dhe teknikat e reja duke përdorur metodologji të reja, efikase në mësimdhënien e gjuhës angleze.
- e. **ENG 450-Psikolinguistikë dhe përvetësim i gjuhës së dytë - Moduli 1:** ENG 450-1 Psikolinguistikë, **Moduli 2:** ENG 450-2 Përvetësim i gjuhës së dytë. **Ngarkesa:** 6 kredite (3 kredite për modul), 2 leksione dhe 1 seminar në javë. Qëllimi kryesor i kursit 'Psikolinguistikë dhe përvetësim i gjuhës së dytë' është që t'i njohë studentët e gjuhës angleze me fushën e psikolinguistikës, e cila është disiplina që heton proceset psikologjike në thelb të përvetësimit, prodhimit dhe të kuptuarit të gjuhës. Kursi është i ndarë në dy module dhe synon t'u japë përgjigje pyetjeve:
Si e përvetësojmë gjuhën?
Si mësojnë fëmijët të bëjnë dallime të holla gramatikore?
A është gjuha një dukuri vetëm njerëzore? Nëse jo, në çfarë mase qeniet e tjera shfaqin sisteme gjuhësore? Nëse po, çfarë dallon psikologjinë dhe biologjinë njerëzore nga ajo e qenieve të tjera nga pikëpamja gjuhësore?
Cila është lidhja midis gjuhës dhe mendimit?
A ka një 'gramatikë universale' të përbashkët për të gjithë gjuhën njerëzore? Nëse ka, cilat janë proceset psikologjike në thelb të saj? Nëse nuk ka, çfarë shpjegimesh të mundshme mund të jepen për ngjashmëritë midis gjuhëve? Cilat janë dallimet në përpunimin e stimujve gojorë dhe shkrimorë?
- f. **ENG 453- Komunikim ndërkulturor - Ngarkesa:** 4 kredite, 2 leksione dhe 1 seminar në javë. Kursi 'Komunikim ndërkulturor' është konceptuar si një kurs hyrës për studentët e këtij programi, të cilët njihen për herë të parë me këtë lëndë. Në këtë kurs, do të trajtohen çështje që kanë të bëjnë me ndërveprimin e njerëzve nga sfonte të ndryshme kulturore dhe gjuhësore, sidomos në një kontekst të gjerë e të diversifikuar të shenjuar nga zhvillimet e teknologjisë, globalizimi dhe lëvizjet migratore. Të rinjtë gjithnjë e më shumë zgjedhin të studiojnë në një vend të ndryshëm nga i tyre, ndër të tjera edhe për të marrë një përvojë të re



REPUBLIKA E SHQIPËRIË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

kulturore. Në këto kushte nevoja për përshtatje dhe ndërtim të marrëdhënieve ndërkulturore bëhet edhe më e madhe. Ky kurs jep shprehje bazë të të kuptuarit të kompleksitetit të komunikimit gjuhësor dhe ndërkulturore në vendndodhje të ndryshme brenda dhe jashtë vendit. Rrit ndërgjegjësimin për domethënien që merr anglishtja si *lingua franca* në një botë gjithnjë edhe më të globalizuar dhe të ndërlidhur si dhe nënvizon rëndësinë e njohjes së gjuhëve të tjera në këto kushte. Në këtë kurs paraqiten koncepte bazë të komunikimit ndërkulturore, duke vënë theksin tek zhvillimet historike në këtë fushë. Studentët nxiten për t'u përfshirë, eksploruar dhe dialoguar me të tjerët gjatë procesit të të zhvilluarit të të kuptuarit se ç'është thotë të jesh ndërkulturore. Shembuj nga jeta reale do të sillen për shqyrtim e diskutim në klasë. Synohet po ashtu rritja e ndërgjegjësimit për përmasat konjitive, afektive dhe sjellimore të kompetencës ndërkulturore dhe cilësitë që lidhen me qytetarinë globale.

- g. **ENG 454 -Kulturë dhe qytetërim i vendeve anglofone- Ngarkesa: 4 kredite, 2 leksione dhe 1 seminar në javë.** Kultura dhe Qytetërimi i vendeve Anglofone ka për qëllim të njohi studentët me zhvillimin e kulturës gjuhësore dhe qytetërimit të vendeve anglofone ndër vite.

Ky kurs është i konceptuar në tri pjesë:

1. Qytetërimi dhe kultura e Mbretërisë së bashkuar.
2. Qytetërimi dhe kultura e Shteteve të Bashkuara të Amerikës.
3. Qytetërimi dhe kultura e vendeve anglisht-folëse.

Ky kurs ka për qëllim të pajisë studentët me njohuritë bazë të zhvillimeve shoqërore, jetën politike, ekonomike dhe kulturore të këtyre vendeve dhe rolin e gjuhës në këtë këndvështrim. Studentët do të prezantohet me konceptet, traditat dhe perspektivat në fushën e zhvillimit gjuhësor- kulturor. Si mësues të ardhshëm të gjuhës angleze studentët do të njihen me format e fundit të metodologjisë së mësimdhënies duke pasur parasysh rëndësinë e të mësuarit të gjuhës nëpërmjet kulturës dhe anasjelltas, duke futur dhe duke e bërë atë si një pjesë thelbësore të mësimin të gjuhës angleze dhe të të nxënës. Studimet kulturore kanë parë zhvillime të mëdha gjatë shekullit të kaluar dhe këtij shekulli. Kjo lëndë kontribuon në zhvillimin e vlerave shoqërore që kanë të bëjnë me barazinë gjinore, demokracisë dhe sigurisht zhvillimet e ndryshmet gjuhësore dhe kulturore.

- h. **ENG 455-Didaktikë e gjuhës angleze-** Moduli 1: Didaktikë e gjuhës angleze Moduli 2: Qasje profesionale ndaj didaktikës së gjuhës angleze. **Ngarkesa: 8 kredite, (4+4) / 2 leksione dhe 1 seminar në javë .** Didaktikë e gjuhës angleze është një disiplinë e formuar dhe e konsoliduar gradualisht, me një objekt studimi të përcaktuar qartë me aktorët e saj dhe instrumentet e veprimit, siç janë: tekstet shkollore dhe formimi i mësuesve në nivele të ndryshme. Ky kurs i shtrirë në dy module: (Moduli 1: ENG 455-1 Didaktikë e gjuhës angleze dhe Moduli 2: ENG 455-2 Qasje profesionale ndaj didaktikës së gjuhës angleze) synon t'u përgjigjet pyetjeve mbi natyrën e procesit të mësimin të gjuhës angleze, mbi metodat e shumëllojshmërinë e teknikave më të përshtatshme të përvetësimit të aftësisë së komunikimit, mbi mësimin e gramatikës, të leksikut, të shprehjeve, të kompetencave, llojet e veprimtarive praktike që do të mbështesin procesin mësimor dhe do të rrisin autonominë e të nxënës, vlerësimin dhe vetëvlerësimin. Studentët do të jenë të aftë të hartojnë dhe shkruajnë plane mësimore, duke i konkretizuar në një "classroom setting" të stimuluar, të reflektojnë mbi eksperiencat personale mësimdhënëse e mësimnxënëse, si edhe të bëjnë krahasimin me metodat e diskutuara në klasë. Didaktika konsiderohet si një kryqëzim ku të gjitha kalimet janë të



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

mundshme dhe në të cilin metodologjia përbën sheshin qendror ku mund të takohen të gjithë: didaktët, mësuesit, nxënësit, hartuesit e programeve, hartuesit e teksteve, formatorët etj.

- i. **ENG 456 - Didaktikë e letërsisë dhe kulturës - Ngarkesa: 4 kredite, 2 leksione dhe 1 seminar në javë.** Kursi 'Didaktikë e letërsisë dhe kulturës' ka një fokus të dyfishtë: nga njëra anë, synon të aftësojë studentin të analizojë dhe shqyrtojë tekste nga gjini të ndryshme dhe nga ana tjetër, që t'i përdorë këto tekste në klasë. Synon të stimulojë analizën individuale të teksteve letrare për të rinjtë, për shembull përmes përdorimit të shkrimit krijues në gjini të ndryshme dhe sipas metodave dhe teorive të ndryshme. Për më tepër, kursi synon ta bëjë studentin të thellohet për kulturën, shoqërinë dhe letërsinë e vendeve anglishtfolëse përpos të kuptuarit qartazi të lidhjes që bart historia. Njohja e letërsisë dhe sesi mund të përshtatet për përdorim në klasë do të vihet në pah. Toleranca dhe të kuptuarit ndërkombëtar janë vlera të integruara në punën me tekste dhe çështje të ndryshme, edhe në shkollën fillore.
- j. **ENG 458 – Sociolinguistikë- Ngarkesa: 3 kredite, 2 leksione dhe 1 seminar në javë.** Në këtë kurs, sociolinguistika mësohet si një degë e gjuhësisë që studion gjuhën në raport me shoqërinë. Objektivi kryesor i sociolinguistikës është të shpjegojë se si variacionet linguistike të folësve (p.sh. sjelljet e tyre të ndryshueshme gjuhësore) janë të lidhura me variacionin në karakteristikat sociale të folësve (dmth prejardhja e tyre sociale). Qëllimi i studimit të sociolinguistikës është për të arritur një përparim të mëtejshëm në njohjen e natyrës dhe funksionit të gjuhës njerëzore nga ana e studimit të gjuhës në kontekstin e saj social. Variant i saj është rezultat i faktorëve të ndryshëm si: feja, mosha, përkatësia etnike, gjinia, etj. Ajo tregon se kombinimi i këtyre komponentëve mbart ndikim në përvetësimin dhe përdorimin e gjuhës.
- k. **ENG 461-Linguistikë e aplikuar- Ngarkesa: 3 kredite, 2 leksione dhe 1 seminar në javë .** Kursi "Linguistikë e aplikuar" është një kurs hyrës, i cili synon t'i pajisë studentët që ndjekin këtë program studimi me njohuri të përmbledhura rreth bazave teorike të mësimdhënies dhe mësimnxënies së gjuhës, të kuptuarit të gjuhës si sistem, në mënyrë të tillë që studentët jo vetëm të marrin njohuri të vlefshme rreth kësaj fushe tejet përfshirëse, por edhe t'i kuptojnë dhe zbatojnë këto njohuri gjatë proceseve të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Studentët do të kenë rritur të kuptuarit e gjuhës si system, duke përfshirë fonologjinë, morfologjinë, sintaksën, semantikën dhe pragmatikën, do të jenë në gjendje t'i zbatojnë këto njohuri në mbështetje të përvetësimit të shprehjeve gjuhësore të dëgjimit, shkrimit, leximit, të folurit, do të dallojnë midis zhvillimit të shkrimit e këndimit në gjuhën e parë dhe në gjuhën e dytë dhe sesi këto ndikojnë tek njëra-tjetra, do të kuptojnë variablat sociokulturore, sociopolitike dhe psikologjike që ndikojnë në përvetësimin e gjuhës së huaj.
- l. **ENG 462- TIK në Mësimdhënien e Gjuhës së Huaj- Ngarkesa: 3kredite / 2 orë në javë, 1 leksion dhe 1 seminar** Komunikimi dhe Teknologjia e Informacionit po pësojnë zhvillim të shpejtë dhe evoluim të vazhdueshëm. Zbatimi i teknologjive në arsim dhe trajnim përfshijnë përparësi që ofrojnë të mësuar në një ambient stimulues dhe të pasur, mbështetur nga një kombinim i burimeve multimediale. Ekziston një mori informacioni në literaturë për mënyrën se si TIK mund të përdoret për t'i ofruar mësimdhënies dhe të nxënës mbështetje, andaj konsiderohet si "*Kopshti i Edenit*" nëse integrohet me sukses në klasat e gjuhëve të huaja. Ky është edhe qëllimi primar i lëndës ENG.462. Pozicionimi i teknologjisë brenda orës së mësimi e shndërron atë në një pjesë të natyrshme të klasës sikurse dhe mjetet e traditës si teksti, fjalori, gjuha apo lapsi dhe fletorja. Tempi i ndryshimit s'mund të jetë i njëtrajtshëm për grupe të ndryshme mësuesish. Disa mund t'i përqafojnë më shpejt shprehjet e reja, të tjerë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

mund të mbeten indiferentë ndaj risive teknologjike, por një gjë është e sigurtë, që teknologjia do të vazhdojë të depërtojë në të gjitha nivelet e mësimdhënies së gjuhëve të huaja. Për këtë, mësuesit kanë nevojë të inkurajohen të integrojnë *blog-un*, *chat-in* krahas mjeteve të tjera për të mos e kthyer mësimdhënien në një ishull të shkëputur nga realitetet e jetës së përditshme.

Në këtë kuadër, modelet dhe përvojat e pasura teknologjike e pedagogjike të kolegëve të huaj që kontribuojnë në vendin tonë, përbëjnë një vlerë dhe një shtysë për mësuesit tanë për arritje të dobishme në një kohë sa më të shkurtër. Çështja e integritetit të TIK në mësimdhënien e gjuhëve, përbën një problem të kohës edhe në Evropë, por në vendin tonë sfidat janë edhe më të mëdha për shkak të nevojës për ndërgjegjësim të mësuesve e nxënësve, e nevojës për mbështetje infrastrukturore e trajnime kualifikuese sistematike të tyre. Çdo ditë e më shumë mësuesit janë duke investuar për t'u pajisur me shprehitë e nevojshme për të vënë në shfrytëzim përparësitë e teknologjisë në punën e tyre, që nga mësuesit që krijojnë materiale mësimore në *Word*, e deri tek përdoruesit e përkushtuar, anëtarë të bashkësive *online*.

- m. **ENG 463- Mësimdhënie e gjuhës së huaj në/për kontekste evropiane-** Moduli 1: Politikat evropiane për gjuhën/Moduli 2: Kuadri evropian i kompetencave gjuhësore/Moduli 3: Ndërkulturalizmi, multilinguizmi dhe plurilinguizmi. **Ngarkesa:** 6 kredite (moduli 1: 1.5 kredite; moduli 2: 2 kredite; moduli 3: 2.5 kredite), 4 seminar në javë. Kursi 'Mësimdhënie e gjuhës së huaj në/për kontekste evropiane' është konceptuar si një kurs hyrës për studentët e këtij programi, të cilët njihen për herë të parë me këtë lëndë. Kursi, i ndarë në tre module, do të trajtojë çështje që kanë të bëjnë me politikat evropiane të gjuhës dhe mësimdhënies së gjuhës së huaj, zbatimin e tyre, kuadrin evropian të gjuhëve, çështje të multilinguizmit, plurilinguizmit, ndërkulturalizmit etj. Ky kurs do t'i aftësojë studentët që të zhvillojnë kompetencën për lidhshmëri gjuhësor, të njohin politikat evropiane të gjuhës, të njohin dokumentacionin, dmth, ligjet, rregullat, kurrikulat etj që lidhen me politikat evropiane gjuhësore, të lidhin kuadrin evropian ligjor të gjuhës me atë kombëtar, të kuptojnë profilin evropian të mësuesit.
- n. **ENG 470- Kërkim në edukim** - Moduli 1: Metodat e kërkimit /Moduli 2: Shkrim propozimesh dhe raportesh kërkimore. **Ngarkesa:** 8 kredite (4 kredite për modul); 2 leksione dhe 1 seminar në javë (moduli 1), 1 leksion dhe 2 seminare në javë (moduli 2). **ENG 470 Kërkim në edukim** - Kursi synon t'u bëjë një hyrje studentëve të nivelit MP në mësimdhënie në gjuhë angleze me drejtim minor në gjuhë italiane për metodat e kërkimit në edukim. Kursi është i konceptuar i ndarë në dy module, i pari teorik dhe i dyti praktik. Moduli i parë i njeh studentët me disa nga konceptet bazë të zbatuara në kërkimin në edukim, tipet e ndryshme të metodave të përdorura, avantazhet dhe disavantazhet e secilës dhe, mbi të gjitha, synon t'i përgatisë seci të kryejnë kërkim. Moduli i dytë ka natyrë praktike dhe vë në zbatim të gjitha njohuritë e marra në modulin e parë përmes punëve dhe detyrave të ndryshme kërkimore që u kërkohen studentëve të kryejnë. Ky kurs do t'i aftësojë studentët që të: 1. të identifikojnë modelet kërkimore duke gjykuar mbi avantazhet dhe disavantazhet e tyre, mjetet dhe teknikat kërkimore e përdorura në secilën, procedurat për mbledhjen dhe analizën e të dhënave etj. 2. të formulojnë pyetje të qarta dhe të mundshme për të bërë kërkim dhe për të pohuar një problem kërkimor. 3. të kryejnë përmbledhje të literaturës me qëllim që të kuptojnë rëndësinë e pyetjeve kërkimore si dhe të identifikojnë hapësira në literaturë. 4. të përgatisim një projekt-propozim përmes koncepteve teorike dhe praktike. 5. të zgjedhin modelin kërkimor të duhur për kërkim. 6. të zgjedhin mjetet e duhura për analizën e të dhënave. 7. të



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

përcaktojnë vlefshmërinë dhe besueshmërinë. 8. të kumtojnë hipotezën e duhur për një problem kërkimor. 9. të përcaktojnë se çfarë mund të konkludohet nga një punë kërkimore.

o. **ENG 490- Praktika profesionale Ngarkesa: 9 kredite, 6 javë**

Në zbatim të kërkesave të planit mësimor, studentët e përfshirë në programin "Master profesional në mësuesi për ciklin e lartë të arsimit bazë në lëndën gjuhë angleze/italiane" do të kryejnë praktikën pedagogjike aktive në shkollat 9-vjeçare (e të mesme). Kursi përmban 9 kredite, të konvertuara në 300 orë. Praktika pedagogjike ka për qëllim të aftësojë studentët nga pikëpamja profesionale për të dhënë mësim, në përputhje me kërkesat bashkëkohore që shtrohen sot për forcimin cilësor të shkollës, dhe për t'i aftësuar me shprehje praktike për shkollën dhe jetën. *Veprimtari të kërkuara nga studentët:* Kandidati të zhvillojë orë mësimi me nivel të mirë, duke u përgatitur seriozisht e me përgjegjësi për orën e mësimi, nga ana shkencore dhe pedagogjike-metodike. Të realizojë, në lidhje organike, të gjitha momentet e orës së mësimi, në bazë të hartimit të plankonspektit të detajuar, duke i kushtuar kujdes realizimit të të gjitha objektivave pedagogjike. Kandidati të përdorë pyetje logjike, argumentime, interpretime, analiza, krahasime, përfundime dhe të nxjerrë konkluzione për dukuritë, ngjarjet e faktet që analizon. Në tërë procesin e punës të udhëhiqet nga përvoja bashkëkohore përëndimore që shprehet në literaturën metodike që qarkullon sot si "Të mësuarit me objektiva". Të krijojë situata problemore në orët e mësimi, duke lidhur natyrshëm punën e mësuesit me atë të nxënësit në orën e mësimi, me një veprimtari të gjallë e efektive. Të aftësojë nxënësit për zgjidhjen e detyrave të pavarura në klasë e në shtëpi në mënyrë krijuese, kundër riprodhimit mekanik.

p. **FRE 431 - Frëngjisht (Frëngjisht 1, Frëngjisht 2)- Ngarkesa: 4 kredite për modul, 8 kredite gjithsej, 3 orë në javë (1 leksion dhe 2 seminare).** Ky kurs u ofrohet studentëve që kanë përvetësuar tashmë nivelin B1 të gjuhës frënge në dy module dhe synon asimilimin në nivel mbimcsatar dhe të përparuar të katër kompetencave: të kuptuarit me gojë e me shkrim, të shprehurit me gojë e me shkrim. Ky kurs lejon paraqitjen në nivelin DELF B2 sipas Kuadrit të Përbashkët Evropian të Referencave për Gjuhët e Huaja. Ky kurs ofron jo vetëm njohuri gjuhësore, por edhe njohuri për historinë e kulturën franceze. Kursi favorizon përfshirjen e studentëve në të nxënë të tyre me qëllim që t'i bëjë ata aktivë në përvetësimin e gjuhës. Ky program ndjek itinerarin e një jete, origjinën, hapësirat e jetës, lidhjen me zakonet kulturore deri në hapjen drejt botës. Kursi synon një ecuri që shkon nga të kuptuarit deri tek të shprehurit.

q. **FRE 454 - Kulturë dhe qytetërim francez - Moduli 1: Kulturë frënge / Moduli 2: Qytetërim francez. Ngarkesa: 4 kredite për modul, 8 kredite gjithsej, 3 orë në javë (1 leksion dhe 2 seminare)** Ky kurs i qytetërimit dhe kulturës franceze bën një paraqitje të zhvillimeve historike, kulturore, sociale, letrare dhe artistike të Francës dhe botës frëngjishtfolëse. Kursi është i konceptuar i ndarë në dy module dhe synon të japë njohuri hyrëse për botën frankofone. Do të prezantohen tekste të shkurtër letrarë, në poezi apo prozë. Për studimin e territorit dhe gjeografisë, artit do të merren në shqyrtim pjesë për të dëgjuar, si dhe do të përdoren harta. Teksti bazë është i ndarë në pesë pjesë. Përvetësimi i njohurive dhe të kuptuarit e zhvillimeve të fundit në fushën e konceptit gjuhë-kulturë. Studimi i faktëve të rëndësishme të kulturës dhe qytetërimit francez brenda dhe jashtë Francës. Vlerësimi i vlerave dhe ndikimin e tyre në atë që shoqëria quan si shumë të rëndësishme të tilla si gjinia, raca, përkatësia etnike, fesë, qeverinë, arsimin, jetën sociale dhe familjare. Zhvillimi i studimeve gjuhësore-kulturore dhe qytetërimit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

- r. **GER 431 - Gjermanisht - Gjermanisht 1, Gjermanisht 2. Ngarkesa: 4 kredite për modul, 8 kredite gjithsej, 3 orë në javë (1 leksion dhe 2 seminare).** Ky kurs u ofrohet studentëve që kanë përvetësuar tashmë nivelin B1 të gjuhës gjermane, në dy module, dhe synon asimilimin në nivel mbimesatar dhe të përparuar të katër kompetencave: të kuptuarit me gojë e me shkrim, të shprehurit me gojë e me shkrim. Ky kurs lejon paraqitjen në nivelin B2 sipas Kuadrit të Përbashkët Evropian të Referencave për Gjuhët e Huaja. Ky kurs ofron jo vetëm njohuri gjuhësore, por edhe njohuri për historinë e kulturën gjermane. Kursi synon përfshirjen e studentëve në të nxënë të tyre me qëllim që t'i bëjë ata aktivë në përvetësimin e gjuhës. Ky program ndjek itinerarin e një jete, origjinën, hapësirat e jetës, lidhjen me zakonet kulturore deri në hapjen drejt botës. Kursi synon një ecuri që shkon nga të kuptuarit deri tek të shprehurit. Synohet që në fund të këtij programi, studentët: a) të kenë një bazë të konsiderueshme të strukturave të përparura të gjuhës gjermane, b) të fitojnë një fjalor të mjaftueshëm për të komunikuar në situatat e jetës së përditshme si dhe një njohje të fjalorit aktiv plotësues, c) të jenë të aftë të kuptojnë gjermanishten e folur me një shpejtësi mbimesatare/të përparuar në bisedë, d) të jenë të aftë të shprehin veten me shkrim në një tekst të nivelit të përparuar, e) të jenë të aftë të lexojnë tekste të ndryshme të nivelit mbimesatar/të përparuar në gjermanisht, f) të asimilojnë shkathhtësitë e komunikimit ndërpersonal, qoftë në shqip, qoftë në gjermanisht, g) të rrisin ndërgjegjësimin dhe vlerësimin e tyre për gjermanishtfolësit dhe për kulturën e tyre, h) të shprehin në mënyrë të qartë dhe të hollësishme mbi një gamë të gjerë temash.
- s. **GER 454- Kulturë dhe qytetërim gjerman - Moduli 1: Kulturë gjermane / Moduli 2: Qytetërim gjerman. Ngarkesa: 4 kredite për modul, 8 kredite gjithsej, 3 orë në javë (1 leksion dhe 2 seminare)** Ky kurs i qytetërimit dhe kulturës gjermane do të jetë një vëzhgim i zhvillimeve historike, politike dhe kulturore të Gjermanisë me theks të veçantë në të tashmen. Kursi, i ndarë në dy module, është i konceptuar për studentët që duan të njihen me zhvillimet historike dhe kulturore të cilat kanë formuar Gjermaninë. Kursi fokusohet në historinë kulturore gjermane nga epoka mesjetare dhe reformimi në epokën pas bashkimit të shekullit të 21-të. Duke theksuar zhvillimin e gjerë të qytetërimit gjerman që nga viti 1500, kurrikula përfshin aspekte në kulturën popullore, letërsinë, historinë sociale, artin, muzikën, mediat moderne dhe teknologjinë. Duke u mbështetur në tekstet dhe pamjet që provokojnë mendime, kursi ofron një pamje të ndryshme të jetës gjermane bazuar në lexime të zgjedhura nga veprat letrare, kujtimet, raportet e gazetave, komentet dhe materialet ndërdisiplinore të cilat nxjerrin në pah lëvizjet e rëndësishme kulturore.
- t. **ITA 431 - Italisht (Italisht 1, Italisht 2) Ngarkesa: 4 kredite për modul, 8 kredite gjithsej, 3 orë në javë (1 leksion dhe 2 seminare)** Programi është hartuar në përputhje me Kuadrin e Përbashkët Evropian të Referencave për Gjuhët (KPER) dhe synon të arrijë dhe të realizojë standardet e mësimdhënies, mësimnxënies dhe vlerësimit, me qëllim që t'i përgjigjet një shoqërie të hapur sipas kërkesave dhe nevojave që shtrohen përpara mësimi dhe përvetësimit të gjuhës së huaj në vendin tonë. Synimet e kursit janë: zhvillimi i aftësive për të folur, dëgjuar, lexuar dhe shkruar tekste të llojeve të ndryshme letrare dhe joletrare, si dhe kërkimi nëpërmjet këtyre teksteve i mendimit kritik e krijues; përdorimi i gjuhës dhe mjeteve të saj në varësi të situatës dhe qëllimit që kanë studentët; gjetja, kuptimi, analiza dhe vlerësimi informacioneve; respektimi i traditave dhe vlerave të kulturave të ndryshme; forcimi i ndërveprimit në situata reale, lidhur me tematikën e trajtuar në situatat mësimore dhe shkëmbimi i informacioneve të detajuara mbi tema që paraqesin interes për studentin;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

thellimi i njohurive gjuhësore, perceptuese dhe shprehëse, përmes të cilave studenti zgjeron njohuritë për botën dhe, në të njëjtën kohë, formohet intelektualisht. Kursi është i konceptuar në dy modele që e çojnë studentin drejt niveleve B2 dhe C1.

- u. **ITAE 454- Kulturë dhe qytetërim italian** - Moduli 1: Kulturë italiane / Moduli 2: Qytetërim italian. **Ngarkesa:** 4 kredite për modul, 8 kredite githsej, 3 orë në javë (1 leksion dhe 2 seminare) Ky kurs i qytetërimit dhe kulturës italiane do të fillojë me detajet e hollësishme të Italisë së sotme, të problemeve të saj dhe të transformimeve që kanë ndodhur në vitet e fundit. Në një moment të dytë studentët do të krahasojnë shprehjet artistike të vendit në fushën e muzikës dhe kulturës. Njohuritë historike mbi Italinë do ta lejojnë studentin të kornizojë më mirë kulturën e qytetërimit të saj. Do të prezantohen tekste të shkurtër letrarë, në poezi apo prozë. Për studimin e territorit dhe gjeografisë do të merren në shqyrtim pjesë për të dëgjuar, si dhe do të përdoren harta. *Rezultatet e të nxënësve:* Përvetësimi i njohurive dhe të kuptuarit e zhvillimeve të fundit në fushën e konceptit gjuhë-kulturë. Studimi i fakteve të rëndësishme të kulturës dhe qytetërimit italian brenda dhe jashtë Italisë. Vlerësimi i vlerave dhe ndikimit të tyre në atë që shoqëria quan si shumë të rëndësishme të tilla si gjinia, raca, përkatësia etnike, fesë, qeverinë, arsimin, jetën sociale dhe familjare. Zhvillimi i studimeve gjuhësore-kulturore dhe qytetërimit.
- v. **PSI 450- Bazat psikologjike të edukimit**- Moduli 1: *Bazat psikologjike të edukimit 1*/ Moduli 2: *Bazat psikologjike të edukimit 2*. **Ngarkesa:** 4 kredite, 2 leksione dhe 1 seminar në javë . Kursi 'Bazat psikologjike të edukimit', i ndarë në module, synon t'u japë studentëve njohuri bazë për psikologjinë e zhvillimit të dobishme për të kuptuar bazat e disiplinave të tjera që vënë në fokus studimin dhe proceset e përvetësimit të gjuhës së huaj. Psikologjia e zhvillimit është një nga disiplinat bazë në formimin profesional të mësuesve. Qëllimi është të njihen studentët me karakteristikat kryesore të zhvillimit sipas moshave të caktuara dhe mënyrat e trajtimit dhe vlerësimit të problemeve që lidhen me moshën duke i ndarë ato nga problemet që lidhen me veçoritë e zhvillimit individual. Në pjesën e dytë të programit studenti merr njohuri rreth të menduarit kritik dhe zhvillimit të tij; mësimdhënia përmes strukturës E.R.R; teknika e pyetjeve dhe vlerësimi; teknika që zhvillojnë të menduarit kritik gjatë procesit të të lexuarit dhe të shkruarit. Në pjesën e tretë psikologji e zbatuar në mësimdhënie trajtohen teoritë e zhvillimit, ndryshimet individuale dhe mësimdhënia; teoritë e të mësuarit, inteligjenca dhe menaxhimi në procesin e të mësuarit.
- w. **SPA 431 - Spanjisht (Spanjisht 1, Spanjisht 2)** (moduli 1/; moduli 2) **Ngarkesa:** 4 kredite për modul, 8 kredite githsej, 3 orë në javë (1 leksion dhe 2 seminare) Kursi 'Spanjisht', i konceptuar i ndarë në dy module, ka si synim ta pajisë studentin me njohuri të gjuhës spanjolle të folur dhe të shkruar si një gjuhë ndërkombëtare. Ky kurs përmban 12 kapituj për çdo modul, secili prej të cilëve përfshin këto rubrika: Përmbajtjen funksionale/Përmbajtjen gramatikore/Tekste dhe leksik/Komponentin strategjik (për zhvillimin e të kuptuarit tekstual)/Përmbajtjen kulturore/Fonetikë/ortografi. Kursi parashihet për studentët të cilët kanë disa njohuri paraprake në gjuhën spanjolle dhe dëshirojnë t'i përparojnë ato në nivelet B2 dhe C1. Ky kurs do t'i aftësojë studentët që të kuptojnë dialogje të gjera edhe kur ato nuk janë të strukturuar në mënyrë të qartë dhe kur marrëdhëniet janë të nënkuptuara dhe jo të shprehura në mënyrë eksplicite, të kuptojnë pa shumë përpjekje programet televizive dhe filmat. të kuptojnë tekstet e gjata dhe komplekse të një natyre letrare ose të bazuara në fakte, duke vlerësuar dallimet stil, të kenë shprehishmëri rrjedhshme dhe spontanisht pa pasur nevojë të kërkonin në mënyrë shumë të dukshme për shprehje të përshtatshme.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

- x. **SPA 454- Kulturë dhe qytetërim spanjoll** - Moduli 1: Kulturë spanjolle- Moduli 2: Qytetërim spanjoll. **Ngarkesa:** 4 kredite për modul, 8 kredite gjithsej, 3 orë në javë (1 leksion dhe 2 seminare) Ky kurs i qytetërimit dhe kulturës spanjolle bën një paraqitje të zhvillimeve historike, kulturore, sociale, letrare dhe artistike të Spanjës dhe botës spanjishtfolëse. Kursi është i konceptuar i ndarë në dy module dhe synon të japë njohuri hyrëse për botën spanjishtfolëse. Do të prezantohen tekste të shkurtër letrarë, në poezi apo prozë. Për studimin e territorit dhe gjeografisë, artit do të merren në shqyrtim pjesë për të dëgjuar, si dhe do të përdoren harta. Teksti bazë është i ndarë në dy pjesë. **Rezultatet e të nxënës:** 1.Përvetësimi i njohurive dhe të kuptuarit e zhvillimeve të fundit në fushën e konceptit gjuhë-kulturë. 2.Studimi i fakteve të rëndësishme të kulturës dhe qytetërimit spanjoll brenda dhe jashtë Spanjës. 3. Vlerësimi i vlerave dhe ndikimin e tyre në atë që shoqëria quan si shumë të rëndësishme të tilla si gjinia, raca, përkatësia etnike, fesë, qeverinë, arsimin, jetën sociale dhe familjare. 4. Zhvillimi i studimeve gjuhësore-kulturore dhe qytetërimit.
- y. **ENG 489 -Provim përfundimtar/Punim diplome- Ngarkesa: 15 kredite**
Provimi i përgjithshëm i formimit është një provim përmbyllës që jepet nga studenti vetëm pasi ka përmbyllur të gjitha detyrimet e tjera akademike për plotësimin e programit të studimit. Provimi i përgjithshëm realizohet me shkrim dhe me gojë. Provimi me shkrim teston nivelin gjuhësor (C1-C2) dhe kulturor të studentit, përgatitjen didaktike përmes ushtrimeve të larmishme dhe aftësinë e të mendurit kritik dhe argumentimit përmes leximit dhe shkrimit. Provimi me gojë ndërtohet në formën e intervistës me pyetje nga disiplina themelore në programin e studimit. Vlerësimi përfundimtar përfshihet nga mësuesit e të dy vlerësimeve të marra së bashkë. Provimi me shkrim do të zëjë 40% të vlerësimit, kurse provimi me gojë 60 %.

Neni 6

Format dhe organizimi i studimit të programit

1. Veprimtaritë formuese që karakterizojnë programin e studimit "Master profesional në mësuesi për ciklin e lartë të arsimit bazë në lëndën gjuhë angleze" ndahen në: mësim në auditor (leksione, seminare,) studim individual (studim, punim relacionesh, detyrash apo projektesh, përgatitje provimesh, përgatitje e tezës së diplomës etj).

Neni 7

Format e kontrollit të dijeve

1. Programi mësimor "Master profesional në mësuesi për ciklin e lartë të arsimit bazë në lëndën gjuhë angleze" parashikon vlerësime vjetore, provime përfundimtare të lëndëve mësimore dhe të provimit të formimit/temës së diplomës.
2. Për modulet e koordinuara (që përmbajnë më shumë se një lëndë) bëhet vlerësimi kolegjal i studentit në bazë të përqindjes së pikëve që ai ka grumbulluar në vlerësimet e secilës prej lëndëve përbërëse të modulit. Format e kontrollit të dijeve përfshijnë detyrat e kursit, projektet, esetë, provimet e kursit, provimet e formimit, temat e diplomave.
3. Kreditet korresponduese për çdo veprimtari formuese fitohen nga studentët vetëm për vlerësim pozitiv në verifikimin përfundimtar të dijeve të fituara prej tyre. Për verifikimin e dijeve përdoren



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE SENATI AKADEMIK

forma të ndryshme që kombinojnë verifikimin e vazhdueshëm (provimet e pjesshme, projektet/detyrat e kursit) me atë përfundimtar (provimin final).

4. Kontrolli i dijes së një lënde (provimi) përcaktohet nga titullari i lëndës dhe mund të bëhet:

- a) me shkrim,
- b) me gojë,
- c) i kombinuar, me shkrim e me gojë,

5. duke u mbështetur në programin mësimor. Vlerësimi përfundimtar i modulit bëhet ose vetëm përmes një provimi përfundimtar, ose përmes një provimi të pjesshëm, një provimi përfundimtar dhe/ose kërkesat specifike që vendos çdo pedagog për lëndën në syllabus.

6. Tezat e provimit, në të gjitha rastet e kontrollit, hartohen dhe firmosen nga titullari i lëndës. Kompromentimi i tezës është përgjegjësi direkte e pedagogut.

Neni 8

Kushtet për t'u konsideruar kalues në një lëndë

1. Shkalla e përvetësimit të programit mësimor vlerësohet me sistemin prej dhjetë notash, 1, ..., 10. Notat nga pesë e lart janë kaluese.
2. Në format e kontrollit me shkrim (provime, detyra/projekte kursi) përdoret sistemi i vlerësimit me pikë, rezultati i të cilit, detyrimisht, konvertohet në notë. Në vlerësimin final të lëndës pedagogu përkatës përcakton edhe peshën e vlerësimit të punës së pavarur të studentit (detyrave/projekteve të kursit).
3. Normat e konvertimit në notë të pikëve të grumbulluara përcaktohen nga pedagogët përkatës në çdo syllabus, por minimumi i përqindjes së pikëve të grumbulluara për marrjen e një vlerësimi pozitiv (me notë 5) është $\geq 40\%$ në të gjitha modulet. Ulja e këtij kufiri mund të bëhet pas daljes së rezultateve të të gjithë grupit, me propozim të pedagogut të lëndës dhe miratim të përgjegjësit të departamentit, kur kjo është e justifikuar dhe e argumentuar.
4. Për modulet e integruara (që përmbajnë më shumë se një lëndë) bëhet vlerësimi kolegjial i studentit në bazë të shumës së përqindjes së pikëve që ai ka grumbulluar në vlerësimet e secilës prej lëndëve përbërëse të modulit. Për të marrë një vlerësim pozitiv përfundimtar, studenti duhet të ketë grumbulluar $\geq 40\%$ jo vetëm të totalit të modulit, por edhe të pikëve përkatëse të çdo lënde përbërëse të modulit të integruar.

Neni 9

Procedurat e testimit dhe apelimit të rezultateve të testimit nga ana e studentëve

1. Procedura e kontrollit të dijeve është si më poshtë:
 - a. Kontrolli i njohurive bëhet thjesht me një provim final, ose me një provim të pjesshëm dhe një provim final, si dhe me anë të detyrave të kursit.
 - b. Pas 48 orësh brenda kryerjes së kontrollit të njohurive (me gojë ose me shkrim) pedagogu njofton studentët për rezultatin e vlerësimit në provim. Ky afat mund të tejkalojë deri në 72 orë në rastet kur pedagogu i lëndës ka zhvilluar më shumë se një provim në një ditë.
2. Studenti ka të drejtë të shikojë fletën e tij të provimit individualisht.
3. N.q.s është i paqartë ose nuk është dakord me vlerësimin që ka marrë, ka të drejtë të kërkojë sqarime nga pedagogu përkatës.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE SENATI AKADEMIK

4. N.q.s studenti është i paqartë ose nuk bindet për rezultatin e provimit, paraqet një kërkesë me shkrim pranë sekretarisë së departamentit.
5. Në bazë të kësaj kërkesë departamenti ngre një komision apelimi *ad hoc* për vlerësimin e kërkesës së studentit. Komisioni duhet të bëjë rivlerësimin e provimit të studentit dhe duhet të japë përgjigje brenda tri ditëve nga çasti i paraqitjes së kërkesës për rivlerësim.
6. Pikët përfundimtare të testimit janë ato të vendosura nga komisioni i apelimit.

Neni 10

Orari i studimit dhe provimeve

1. Koha dhe auditori i zhvillimit të mësimit përcaktohet në orarin e shpallur nga Departamenti i Gjuhëve të Huaja. Orari duhet të respektohet plotësisht nga të gjithë studentët dhe mësuesit.
2. Orari i përgjithshëm i universitetit duhet të shpallet të paktën 3 javë përpara fillimit të semestrit. Orari i provimeve finale duhet të shpallet jo më vonë se 3 javë nga mbarimi i semestrit.
3. Orari duhet të përmbajë: kodin dhe emërtimin e lëndës, orarin, sallën ku do të kryhet mësimi/provimi dhe emrin e pedagogut përkatës.

Neni 11

Detyrimet e mundshme që lidhen me frekuentimin

1. Frekuentimi i leksioneve është i detyrueshëm në masën 75%.
2. Frekuentimi i seminareve është i detyrueshëm në masën 75%.

Neni 12

Karakteristikat e detyrave/projekteve të kursit

1. Detyrat dhe projektet e kursit mund të jenë disa lloje: ese ose kërkim në fushën përkatëse, projekt kërkimor, punë prezantuese, poster.
2. Kërkesat për mënyrën e organizimit të detyrës, përmbajtjen, mënyrën e paraqitjes së punimit, përgatitjen teknike të tij/saj përcaktohen nga pedagogu përkatës.

Neni 13

Vlerësimi për diplomim

1. Studentët diplomohen me provim të përgjithshëm ose punim diplome.
2. Studenti mesatarja e përgjithshme e të cilit është 8.5 (vlerësimet e marra në semestrin e parë), i njihet e drejta të realizojë punim diplome.
3. Punimet e diplomës duhet të përmbushin kërkesat e mëposhtme:
 - a. Të jenë studime individuale,
 - b. Të jenë studime deskriptive apo analitike.
 - c. Me udhëheqje shkencore apo krejtësisht të pavarura,
 - d. Të ndjekin rregullat e shpallura nga DGJH për paraqitjen e punimit, bazuar në shtojcat në Vendimin e Senatit Akademik Nr. 65, datë 14.11.2016, si dhe Rregulloren e punimeve të miratuar nga DGJH (shtojcat bashkëlidhur).





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE SENATI AKADEMIK

4. Provimi i përgjithshëm realizohet me shkrim dhe me gojë. Provimi me shkrim teston nivelin gjuhësor të studentit (C1/C2) përmes ushtrimeve gjuhësore (gramatikore dhe leksikore), si dhe njohuritë kulturore e aftësinë e të mendurit kritik dhe argumentimit përmes leximit dhe shkrimit. Provimi me gojë ndërtohet në formën e intervistës me pyetje nga disiplina themelore në programin e studimit. Vlerësimi përfundimtar përftohet nga mesatarja e të dy vlerësimeve bashkë.

Neni 14

Modalitetet për dhënien e diplomës

1. Në përfundim të kursit të plotë të studimeve, studentët kanë të drejtë të diplomohen. Kërkesat për fitimin e diplomës së ciklit të dytë të studimeve janë:

- Studenti duhet të jetë vlerësuar pozitivisht në të gjitha modulet e detyrueshme në disiplinat:
 - e formimit bazë (2)
 - karakterizues (6)
 - ndërdisiplinore/integruese (4)
 - plotësuese (2)
- Studenti duhet të ketë vlerësim 'kalues' në provimin e formimit/punimin e diplomës.
- Në përfundim të studimeve të ketë grumbulluar të 120 ECTS (kredite).

2. Pasi ka shlyer të gjitha detyrimet akademike dhe financiare, studenti paraqitet pranë sekretarisë mesimore të DGJH-së për të kryer procedurat përkatëse.

Neni 15

Shkeljet e integritetit akademik

1. Të gjithë anëtarët e komunitetit akademik duhet të praktikojnë dhe të ruajnë standardet e integritetit akademik dhe ndershmërisë. Integritet akademik do të thotë të paraqesësh vetveten dhe punën tënde me ndershmëri. Prezantimi i keq i vetvetes dhe punës është mashtrim, sepse do të thotë që studentët pretendojnë kredite për ide apo punë që nuk janë në të vërtetë vepër e tyre dhe në këtë mënyrë kërkojnë një diplomë që në të vërtetë nuk është fituar. Më poshtë janë disa shembuj pandershmërie akademike:

- Mashtrim në provime. Këtu përfshihen të përdorësh materiale si libra dhe/ose shënime atëherë kur një gjë e tillë nuk është e autorizuar nga pedagogu, të kopjosh nga testimi apo detyra e dikujt tjetër, të ndihmosh dikë tjetër të kopjojë punën, të zëvendësosh punën e dikujt tjetër me punën tënde, të vjedhësh kopje të provimeve, ose të tjera forma shkeljesh në sjelljeje gjatë provimeve.
- Plagjiaturë e punës së të tjerëve. Plagjiaturë do të thotë të përdorësh punën ose idetë e dikujt tjetër pa i dhënë atij personi kredit për punën e vet; duke bërë këtë studentët pretendojnë kredit për mendimin e dikujt tjetër. Studentët duhet të dokumentojnë gjithmonë burimin e informacionit qoftë atëherë kur e kanë lexuar edhe atëherë kur e kanë dëgjuar. Kur punohet me burime të shkruara, një dallim i qartë duhet bërë midis thonjzave (të cilat riprodhojnë informacionin fjalë për fjalë nga burimi dhe e vendosin atë midis thonjzave) dhe perifrazimeve (të cilat e përpunojnë burimin e informacionit dhe e paraqesin atë me fjalët e studentit. Qoftë citimet midis thonjzave, qoftë perifrazimet duhen të dokumentohen në çdo rast. Edhe në rastin kur studentët rishprehin, përmbledhin apo përzgjedhin pjesë nga puna e tjetrit, idetë i përkasin në çdo rast personit tjetër, dhe mosdhënia kredit punës së tij përbën prezantim të keq të punës aktuale të studentit dhe plagjiaturë e ideve të dikujt tjetër. Të blesh një detyrë kursi ose të përdorësh informacion nga Rrjeti



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

Ndërkombëtar i Informacionit ose Interneti pa njohur burimin dhe ta dorëzosh atë si punë vetjake është plagjiaturë.

- c. Falsifikimi i dokumentave apo paraqitja dizinformuese e kredencialeve të një personi është shkelje.
- d. Bashkëpunimi i paautorizuar në detyra kompjuterike dhe hyrje e paautorizuar dhe përdorimi i programeve kompjuterikë duke përfshirë modifikimin e skedar kompjuterikë të krijuar nga të tjerë dhe të paraqesësh atë punë si punën tënde është shkelje. Me përjashtim të rasteve kur japin udhëzime specifike, në të gjitha rastet pedagogët presin prej studentëve punë individuale pa ndihmën e të tjerëve në detyra kursi, provime, raporte laboratorit dhe ushtrime kompjuterike, si dhe dokumentacion të të gjitha burimeve në rastet kur këto vihen në përdorim. Nëse pedagogët caktojnë një projekt të veçantë përveç ose si shtesë ndaj provimeve, si për shembull detyrë kursi e bazuar në punë kërkimore, apo ese origjinale ose referatë e një libri, ata kanë përcaktuar që kjo punë është përmbushur vetëm për atë kurs. Studentët nuk duhet të dorëzojnë punën e kryer në një kurs që është marrë në të kaluarën apo për një kurs bashkëekzistues, përveç rasteve kur studenti ka leje të qartë për të bërë kështu nga të dy anëtarët e personelit akademik që janë pedagogë të kurseve.

Neni 16
Dispozita të veçanta

1. Departamenti i Gjuhëve të Huaja dhe njësitë e tjera bashkëpunuese në këtë program kanë të drejtën dhe detyrimin e rishikimit periodik të kësaj rregulloreje, sidomos përsa i përket numrit të krediteve që i jepen çdo disipline të veçantë mësimore ose veprimtarie tjetër formuese.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK**

**RREGULLORE E PROGRAMIT TË STUDIMIT
"MASTER PROFESIONAL NË MËSUESI PËR CIKLIN E LARTË TË ARSIMIT BAZË NË
LËNDËN GJUHË ITALIANE"**

Kjo rregullore është hartuar mbështetur dhe në zbatim të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", si dhe në udhëzimin nr. 41, datë 24.1.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", Statutin dhe Rregulloren e Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë.

Neni 1

Emërtimi dhe statusi i programit

1. Programi i studimit "Master profesional në mësuesi për ciklin e lartë të arsimit bazë në lëndën gjuhë italiane" ofrohet nga Departamenti i Gjuhëve të Huaja, Fakulteti i Shkencave Humane, në koordinim të veprimtarive formuese, edhe me njësitë e tjera të këtij fakultetit dhe të Fakultetit të Shkencave Teknike. Ky program studimi është program i ciklit të dytë, "Master", i cili ofrohet në dy vite akademik, në përfundim të të cilit studenti grumbullon 120 kredite (ECTs) dhe merr diplomën: "Master profesional në mësuesi për ciklin e lartë të arsimit bazë në lëndën gjuhë italiane".
2. Përveç njësive bazë dhe kryesore, programi do të realizohet edhe me mbështetjen e entiteve shtetërore dhe private që kanë nevojë për personel administrativ të kualifikuar dhe të pajisur me shprehinë përkatëse.

Neni 2

Objektivat formues të programit

1. Ky program synon përgatitjen e specialistëve në mësimdhënie, mësimnxënie, vlerësim, përgatitje gjuhësore dhe komunikative të nxënësve për testime kombëtare dhe ndërkombëtare, situata të ndryshme pune e shkollimi në gjuhën italiane të pajisur me:
 - a. njohuri të përgjithshme në shkencat filologjike;
 - b. formim të plotë psiko-pedagogjik;
 - c. formim profesional, të plotë e bashkëkohor në metodikën e didaktikën e gjuhës së huaj;
 - d. aftësi për të komunikuar në dy gjuhë të huaja (anglisht dhe italisht/frëngjisht/spanjisht/gjermanisht) në mjedis pune dhe situata komunikimi;
 - e. njohuri të plota teorike në lidhje me strukturën dhe funksionimin e gjuhëve të studimit (anglisht dhe italisht/frëngjisht/spanjisht/gjermanisht);
 - f. njohuri përreth kulturës së vendeve gjuhën e së cilës studiojnë;
 - g. aftësi për të ndërtuar marrëdhënie komunikimi dhe pune në një mjedis ndërkulturor në institucione që bashkëpunojnë dhe ndërveprojnë me partnerë dhe bashkëpunëtorë që u përkasin kulturave të ndryshme.
 - h. aftësi për mësimdhënie, vlerësim, përgatitje gjuhësore dhe komunikative të nxënësve për testime kombëtare dhe ndërkombëtare;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

- i. aftësi për të kuptuar sistemet gjuhësore, proceset e përvetësimit të gjuhës së huaj, politikat vendase dhe evropiane për gjuhën;
- j. njohuri të plota rreth kontaktit evropian të të mësuarit dhe të nxënësve të gjuhës së huaj, çështjeve si plurilinguizmi, multilinguizmi, ndërkulturalizmi dhe sesi qasen këto nga një perspektivë evropiane;
- k. ndjesi të formuar për qytetari evropian me qëllim për ta vënë këtë në shërbim të formimit të brezave të rinj.
- l. aftësi për të kryer kërkim në fushën e studimit të kryer.

Neni 3

Disiplinat dhe veprimtaritë formuese të programit sipas krediteve

1. Kurrikula e programit të studimit "Master profesional në mësuesi për ciklin e lartë të arsimit bazë në lëndën gjuhë italiane" organizohet në:
 - a. Lëndë bazë;
 - b. Lëndë karakterizuese;
 - c. Lëndë ndërdisiplinore/ integruuese;
 - d. Lëndë plotësuese;
 - e. Detyrime përmbyllëse.
2. Kurset/lëndët në program dallohen nga emërtimi, kodi dhe numri i krediteve. Kodi përcakton këta elemente: gjuhën në të cilën zhvillohet kursi ose fushën e studimit të cilës i përket dhe vitin e studimit në të cilin ofrohet. Kështu, kurset/lëndët me kode "ITA ..." zhvillohen në gjuhën italiane, me "ENG ..." në gjuhën angleze, me "ALB ..." në gjuhën shqipe, me "FRE ..." në gjuhën frënge, me "SPA ..." në gjuhën spanjolle, me "CS..." ofrohen nga Departamenti i Informatikës.
3. Përmbajtja tematike e kurseve, të dhënat mbi kursin, mënyrën e vlerësimit, kontrollit të dijes, literatura e detyruar et. paraqiten në *syllabus*-et përkatëse të çdo lënde dhe shpallen në fillim të semestrit nga pedagogu përkatës.
4. Më poshtë paraqitet lista e disiplinave dhe veprimtaritë formuese të programit të shprehura të ndara në kredite për disiplinë dhe tipin e komponentit mësimor si vijon:

B. Lëndë bazë – 12 kredite

ITA 441 Bazat kulturore të edukimit (për gjuhën italiane)	4 kredite
ITA 442 Metodat e mësimdhënies	8 kredite (4+4)
Moduli 1: ITA 442-1 Vështrim historik i metodave të mësimdhënies	4 kredite
Moduli 2: ITA 442-2 Metodat bashkëkohore të mësimdhënies	4 kredite

Lëndë karakterizuese – 44 kredite

ITA 440 Bazat pedagogjike të edukimit	8 kredite (4+4)
Moduli 1: ITA 440-1 Bazat e pedagogjisë	4 kredite
Moduli 2: ITA 440-1 Pedagogjia e gjuhës së huaj/dytë	4 kredite
PSI 450 Bazat psikologjike të edukimit	8 kredite (4+4)





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

<i>Moduli 1:</i> PSI 450-1 Bazat psikologjike të edukimit 1	4 kredite
<i>Moduli 2:</i> PSI 450-1 Bazat psikologjike të edukimit 2	4 kredite
ITA 454 Kulturë dhe qytetërim italian	4 kredite
ITA 453 Komunikim ndërkulturor	4 kredite
ITA 470 Kërkim në edukim	8 kredite (4+4)
<i>Moduli 1:</i> ITA 470-1 Metodat e kërkimit	4 kredite
<i>Moduli 2:</i> ITA 470-2 Shkrim propozimesh dhe raportesh kërkimore	4 kredite
ITA 455 Didaktikë e gjuhës italiane	8 kredite (4+4)
<i>Moduli 1:</i> ITA 455-1 Didaktikë e gjuhës italiane	4 kredite
<i>Moduli 2:</i> ITA 455-2 Qasje profesionale ndaj didaktikës së gjuhës italiane	4 kredite
ITA 456 Didaktikë e letërsisë dhe kulturës	4 kredite
Lëndë ndërdisiplinore/ integruese – 37 kredite	
ITA 450 Psikolinguistikë dhe përvetësim i gjuhës së dytë	6 kredite (3+3)
<i>Moduli 1:</i> ITA 450-1 Psikolinguistikë	3 kredite
<i>Moduli 2:</i> ITA 450-2 Përvetësim i gjuhës së dytë	3 kredite
ITA 458 Sociolinguistikë	3 kredite
ITA 461 Linguistikë e aplikuar	3 kredite
ITA 462 TIK në mësimdhënien e gjuhës së huaj	3 kredite
ITA 463 Mësimdhënie e gjuhës së huaj në/për kontekste evropiane	6 kredite
<i>Moduli 1:</i> ITA 463-1 Politikat evropiane për gjuhën	1.5 kredite
<i>Moduli 2:</i> ITA 463-2 Kuadri evropian i kompetencave gjuhësore	2 kredite
<i>Moduli 3:</i> ITA 463-3 Ndërkulturalizmi, multilinguizmi dhe plurilinguizmi	2.5 kredite
<i>Zgjidh një nga:</i>	
ENG 431 Anglisht/FRE 431 Frëngjisht/GER 431 Gjermanisht/SPA 431 Spanjisht	8 kredite (4+4)
<i>Moduli 1:</i> ENG 431-1 Anglisht (B2)/FRE 431-1 Frëngjisht (B2)//GER 431-1 Gjermanisht (B2)//SPA 431-1 Spanjisht (B2)	4 kredite
<i>Moduli 2:</i> ENG 431-2 Anglisht (C1)/FRE 431-2 Frëngjisht (C1)//GER 431-2 Gjermanisht (C1)//SPA 431-2 Spanjisht (C1)	4 kredite



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

Zgjidh një nga:

8 kredite (4+4)

ENGI 454 Kulturë dhe qytetërim anglez/FRE 454 Kulturë dhe qytetërim francez/GER 454 Kulturë dhe qytetërim gjerman/SPA 454 Kulturë dhe qytetërim spanjoll

4 kredite

Moduli 1: ENGI 454-1 Kulturë angleze/ FRE 454-1 Kulturë frënge/GER-1 454 Kulturë gjermane/SPA 454-1 Kulturë spanjolle

Moduli 2: ENGI 454-2 Qytetërim anglez/ FRE 454-2 Qytetërim francez/GER-2 454 Qytetërim gjerman/SPA 454-2 Qytetërim spanjoll

4 kredite

Lëndë plotësuese – 12 kredite

CSE 446 Komunikim dhe teknologji e informacionit në edukim

3 kredite

ITA 490 Praktikë profesionale

9 kredite

Detyrime përmbyllëse – 15 kredite

ITA 489 Provim përfundimtar/Punim diplome

15 kredite

Shënim: Lënda konsiderohet e shlyer nëse të gjitha modulet kanë nota kaluese.

Neni 4
Plani mësimor

1. Më poshtë paraqitet plani mësimor i studimit, i detajuar me semestra, me disiplinat dhe veprimtaritë formuese përkatëse të programit të shprehura të ndara në kredite, orë mësimore në auditor dhe jashtë auditorit për disiplinë si vijon:

Plani mësimor "Master Profesional në mësimdhënie për CLAB në gjuhë italiane"

Viti	Semestri I	Kodi	Lënda	Kredite	Tot. orë / semestër brenda & jashtë auditorit	Tot. orë / semestër në auditorit	Totali orë / javë në auditorit		Totali orë jashtë auditorit
							lex	sem	
		ITA 440/(ENG 440-1)	Bazat pedagogjike të edukimit/Moduli 1: Bazat e pedagogjisë	4	100	45	2	1	55
		ITA 440/(ENG 440-2)	Bazat pedagogjike të edukimit/Moduli 2: Pedagogjia e gjuhës së huaj/dytë	4	100	45	2	1	55
		PSI 450/(PSI 450-1)	Bazat psikologjike të edukimit/Moduli 1: Bazat psikologjike të edukimit 1	4	100	45	2	1	55
		PSI 450/(PSI 450-2)	Bazat psikologjike të edukimit/Moduli 2: Bazat psikologjike të edukimit 2	4	100	45	2	1	55



REPUBLIKA E SHQIPËRIË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

Viti 2	Semestri 2	ITA 442/(ENG 442-1)	Metodat e mësimdhënies/ <i>Moduli 1</i> : Vështrim historik i metodave të mësimdhënies	4	100	45	2	1	55
		ITA 458	Sociolinguistike	3	75	45	2	1	30
		ITA 461	Linguistikë e aplikuar	3	75	45	2	1	30
		Zgjidh një nga: ENG 431/(ENG 431-1) FRE 431/(FRE 431-1) GER 431/(GER 431-1) SPA 431/(SPA 431-1)	Zgjidh një nga: Anglisht/ <i>Moduli 1</i> : Anglisht 1 (B2) Frëngjisht/ <i>Moduli 1</i> : Frëngjisht 1 (B2) Gjermanisht/ <i>Moduli 1</i> : Gjermanisht 1 (B2) Spanjisht/ <i>Moduli 1</i> : Spanjisht 1 (B2)	4	100	45	1	2	55
		TOTALI		30	750	360	15	9	390
		ITA 441	Bazat kulturore të edukimit	4	100	45	2	1	55
		ITA 454	Kulturë dhe qytetërim italian	4	100	45	2	1	55
		ITA 442/(ITA 442-2)	Metodat e mësimdhënies/ <i>Moduli 2</i> : Metodat bashkëkohore të mësimdhënies	4	100	45	2	1	55
		ITA 450/(ITA 450-1)	Psikolinguistikë dhe përvetësim i gjuhës së dytë/ <i>Moduli 1</i> : Psikolinguistikë	3	75	45	2	1	30
		ITA 450/(ITA 450-2)	Psikolinguistikë dhe përvetësim i gjuhës së dytë/ <i>Moduli 2</i> : Përvetësim i gjuhës së dytë	3	75	45	2	1	30
	Semestri 3	Zgjidh një nga: ENG 431/(ENG 431-2) FRE 431/(FRE 431-2) GER 431/(GER 431-2) SPA 431/(SPA 431-2)	Zgjidh një nga: Anglisht/ <i>Moduli 1</i> : Anglisht 2 (C1) Frëngjisht/ <i>Moduli 1</i> : Frëngjisht 2 (C1) Gjermanisht/ <i>Moduli 1</i> : Gjermanisht 2 (C1) Spanjisht/ <i>Moduli 1</i> : Spanjisht 2 (C1)	4	100	45	1	2	55
		Zgjidh një nga: ENG 454/(ENG 454-1) FRE 454/(FRE 454-1) GER 454/(GER 454-1) SPA 454/(SPA 454-1)	Zgjidh një nga: Kulturë dhe qytetërim i vendeve anglofone/ <i>Moduli 1</i> : Kulturë anglofone Kulturë dhe qytetërim francez/ <i>Moduli 1</i> : Kulturë frënge Kulturë dhe qytetërim gjerman/ <i>Moduli 1</i> : Kulturë gjermane Kulturë dhe qytetërim spanjoll/ <i>Moduli 1</i> : Kulturë spanjolle	4	100	45	1	2	55
		Zgjidh një nga: ENG 454/(ENG 454-2) FRE 454/(FRE 454-2) GER 454/(GER 454-2) SPA 454/(SPA 454-2)	Zgjidh një nga: Kulturë dhe qytetërim i vendeve anglofone/ <i>Moduli 2</i> : Qytetërim i vendeve anglofone Kulturë dhe qytetërim francez/ <i>Moduli 2</i> : Qytetërim francez Kulturë dhe qytetërim gjerman/ <i>Moduli 2</i> : Qytetërim gjerman Kulturë dhe qytetërim spanjoll/ <i>Moduli 2</i> : Qytetërim spanjoll	4	100	45	1	2	55
		TOTALI		30	750	360	13	11	390
	Semestri 3	ITA 455/(ITA 455-1)	Didaktikë e gjuhës italiane/ <i>Moduli 1</i> : Didaktikë e gjuhës angleze 1	4	100	45	2	1	55
		ITA 455/(ITA 455-2)	Didaktikë e gjuhës italiane/ <i>Moduli 2</i> : Qasje profesionale ndaj didaktikës së gjuhës italiane	4	100	45	2	1	55
		ITA 456	Didaktikë e letërsisë dhe kultures	4	100	45	2	1	55
		ITA 453	Komunikim ndërkulturor	4	100	45	2	1	55
		ITA 470/(ITA 470-1)	Kërkim në edukim/ <i>Moduli 1</i> : Metodat e kërkimit	4	100	45	2	1	55
		ITA 470/(ITA 470-2)	Kërkim në edukim/ <i>Moduli 2</i> : Shkrim propozimesh dhe raportesh kërkimore	4	100	45	2	1	55
		ITA 463/(ITA 463-1)	Mësimdhënie e gjuhës së huaj në/për kontekste evropiane/ <i>Moduli 1</i> : Politikat evropiane për gjuhën	1.5	60	45	2	1	90
		ITA 463/(ITA 463-2)	Mësimdhënie e gjuhës së huaj në/për kontekste evropiane/ <i>Moduli 2</i> : Kuadri evropian i kompetencave gjuhësore	2					
		ITA 463/(ITA 463-3)	Mësimdhënie e gjuhës së huaj në/për kontekste evropiane/ <i>Moduli 3</i> : Ndërkulturalizmi, multilinguizmi dhe plurilinguizmi	2.5					



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

TOTALI			30	750	330	11	11	420
Semestri 4	CSE 446	Komunikim dhe teknologji e informacionit në edukim	3	75	30	1	1	45
	ITA 462	TIK në mësimdhënien e gjuhës së huaj	3	75	30	1	1	45
	ITA 490	Praktikë profesionale	9	225	0	0	0	225
	ITA 499	Provim përfundimtar/Punim diplome	15	375	0	0	0	375
TOTALI			30	750	60	2	2	690

Neni 5

Përshkrimi i disiplinave që ngërthen programi

1. Ky program studimi ngërthen këto disiplina dhe detyrime akademike, përshkrimet e të cilave paraqiten si vijon:

- a. **CSE 446-Komunikim dhe teknologji e informacionit në edukim- Ngarkesa:** 3 kredite, 1 leksion dhe 1 seminar në javë. Në këtë kurs synohet të jepet njohuri mbi teknologjitë e informacionit dhe të komunikimit në mësimdhënien në mënyrë që studentët të fitojnë njohje dhe kompetenca përdorimi të TIK në procesin mësimor për ta bërë atë sa më efektiv. Lënda do të synojë në mënyrë specifike të aftësojë studentin që të integrojë mjetet kryesore që ofron TIK në orën e mësimi. Ky kurs ka për qëllim të pajisë studentët me njohuri mbi kompjuterat, pjesët përbërëse dhe paisjet periferike të kompjuterave, llojet e lidhjeve të kompjuterave në rrjet. Gjithashtu ky kurs ka si qëllim të pajisë studentët me njohuri të avancuara në përdorimin e programeve bazë të domosdoshme në mësimdhënien, të njohurive në përdorimin e internetit, gjuhëve të programimit dhe algoritmave të thjeshtë.
- b. **ITA 440 Bazat pedagogjike të edukimit (moduli 1: Bazat e pedagogjisë; moduli 2: Pedagogjia e gjuhës së huaj/dytë) . Ngarkesa:** 4 kredite për modul, 8 kredite. Ky kurs ofron një kualifikim të përgjithshëm në fushën e pedagogjisë e mësimdhënies për studentët e masterit profesional me drejtim mësuesinë, pasi nuk është asnjëherë e mjaftueshme nxënica deri në skajet limite të arsimit. Ky program përfshinë, në thelb, mësimdhënien dhe mësimnxënien por edhe promovimin e studentit tashme të mirë integruar të aftë për të marrë një rol të përgjegjshëm, aktiv në shoqëri. Me një qëllim të tillë në mendje, individ mund të arrijë më shumë informacion, më shumë nxënie duke u fokusuar e përzgjedhur një analizë psikologjike të objektivave në rritjen e aftësive intelektuale dhe njohuritë sociale (mbi baze njohje), mësimin e shkathtësive praktike aktive (të mësuarit psikomotorike), dhe zhvillimin e ndjenjave, qëndrimet, vlerat dhe të mësuarit (emocional e praktik). Përvetësimi i diturisë përfshin të kuptuarin e informacioneve të reja. Aftësitë-Ndërtimin e strategjive mbi fokusin për të mësuar një aftësi të re të veçantë për të përmirësuar rritjen profesionale. Kjo është zakonisht e realizueshme edhe përmes programeve praktike.
- c. **ITA 441-Bazat kulturore të edukimit. Ngarkesa:** 4 kredite, 2 leksione dhe 1 seminar në javë . Qëllimi kryesor i kursit ENG 441 'Bazat Kulturore të Edukimit' është që t'i ofrojë studentëve të gjuhës angleze në ciklin e dytë të studimeve universitare njohuri të përgjithshme në lidhje me aspektet kulturore si dhe zbatimin e tyre në fushën e arsimit, kryesisht atij nëntëvjeçar. Kursi ofron jo vetëm trajtime teorike, por edhe shembuj konkret të aspekteve kulturore në fushën e arsimit të brezit të ri. Studentët do të mund të dëshmojnë vlerësim për çështjet kulturore që shfaqen në praktikën arsimore, të artikulojnë pyetje gjenerative për origjinën dhe pasojat e



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

zgjedheve edukative, të reflektojnë rreth impaktit të lidhjes midis bazave të kulturës dhe praktikës arsimore të asaj kulture teksa përpiqen të krijojnë një mjedis ku mund të mësojnë.

d. **ITA 442- Metodatat e mësimdhënies. Moduli 1:** Vështrim historik i metodave të mësimdhënies /Moduli 2: Metodatat bashkëkohore të mësimdhënies. **Ngarkesa:** 8 kredite (4 kredite për modul), 2 leksione dhe 1 seminar në javë. Ky kurs ka për qëllim të pajisë studentët me njohuri për zhvillimin e metodologjive të mësimdhënies të gjuhës italiane. Ky kurs do të diskutojë, analizojë dhe praktikojë një shumëllojshmëri të metodologjive të mësimdhënies të gjuhës në mënyrë që të përgatisë studentët për mësimdhënien e gjuhës italiane duke nisur nga metoda gramatikore e deri tek qasja komunikative. Ky kurs gjithashtu do të sigurojë modelet e nevojshme për zhvillimin e mësimi mbi planet mësimore që t'i aftësojë në praktikën e mësimdhënies. Studentët do të pajisen me njohuri mbi metodatat, teknikat dhe strategjitë e ndryshme mësimore. Ata do të kuptojnë se ka shumë teknika që mund të integrohen në mësimdhënien e tyre duke bërë të mundur që ata shprehin besimet dhe mendimet e tyre mbi mësimdhënien dhe të nxënit. Ata do të jenë në gjendje të reflektojnë mbi përvojat e tyre dhe t'i krahasojnë ato me metodologjitë e diskutuara në klasë duke praktikuar njohuritë që do të marrin në teori me anë të simulimeve të orëve mësimore në gjuhën italiane. Studentët do të jenë në gjendje të bëjnë vendimarrjet mbi mësimdhënien efektive duke u bazuar mbi parimet dhe teknikat e mësuara në klasë. Në fund të këtij kursi studentët do të jenë në gjendje të zbatojnë parimet dhe teknikat e reja duke përdorur metodologji të reja, efikase në mësimdhënien e gjuhës italiane.

e. **ITA 450-Psikolinguistikë dhe përvetësim i gjuhës së dytë** - Moduli 1: ITA 450-1 Psikolinguistikë, Moduli 2: ITA 450-2 Përvetësim i gjuhës së dytë. **Ngarkesa:** 6 kredite (3 kredite për modul), 2 leksione dhe 1 seminar në javë. Qëllimi kryesor i kursit 'Psikolinguistikë dhe përvetësim i gjuhës së dytë' është që t'i njohë studentët e gjuhës angleze me fushën e psikolinguistikës, e cila është disiplina që heton proceset psikologjike në thelb të përvetësimit, prodhimit dhe të kuptuarit të gjuhës. Kursi është i ndarë në dy module dhe synon t'u japë përgjigje pyetjeve:

Si e përvetësojmë gjuhën?

Si mësojnë fëmijët të bëjnë dallime të holla gramatikore?

A është gjuha një dukuri vetëm njerëzore? Nëse jo, në çfarë mase qeniet e tjera shfaqin sisteme gjuhësore? Nëse po, çfarë dallon psikologjinë dhe biologjinë njerëzore nga ajo e qenieve të tjera nga pikëpamja gjuhësore?

Cila është lidhja midis gjuhës dhe mendimit?

A ka një 'gramatikë universale' të përbashkët për të gjithë gjuhën njerëzore? Nëse ka, cilat janë proceset psikologjike në thelb të saj? Nëse nuk ka, çfarë shpjegimesh të mundshme mund të jepen për ngjashmëritë midis gjuhëve? Cilat janë dallimet në përpunimin e stimulave gojorë dhe shkrimorë?

f. **ITA 453- Komunikim ndërkulturor** - **Ngarkesa:** 4 kredite, 2 leksione dhe 1 seminar në javë. Kursi 'Komunikim ndërkulturor' është konceptuar si një kurs hyrës për studentët e këtij programi, të cilët njihen për herë të parë me këtë lëndë. Në këtë kurs, do të trajtohen çështje që kanë të bëjnë me ndërveprimin e njerëzve nga sfonde të ndryshme kulturore dhe gjuhësore, sidomos në një kontekst të gjerë e të diversifikuar të shenjuar nga zhvillimet e teknologjisë, globalizimi dhe lëvizjet migratore. Të rinjtë gjithnjë e më shumë zgjedhin të studiojnë në një vend të ndryshëm nga i tyre, ndër të tjera edhe për të marrë një përvojë të re kulturore. Në këto kushte nevoja për përshtatje dhe ndërtim të marrëdhënieve ndërkulturore bëhet edhe më e madhe. Ky kurs jep shprehje bazë të të kuptuarit të kompleksitetit të komunikimit gjuhësor dhe



REPUBLIKA E SHQIPËRIË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË SENATI AKADEMIK

ndërkulturore në vendndodhje të ndryshme brenda dhe jashtë vendit. Rrit ndërgjegjësimin për domethënien që merr italishtja si *lingua franca* në një botë gjithnjë edhe më të globalizuar dhe të ndërlikuar si dhe nënvizon rëndësinë e njohjes së gjuhëve të tjera në këto kushte. Në këtë kurs paraqiten koncepte bazë të komunikimit ndërkulturore, duke vënë theksin tek zhvillimet historike në këtë fushë. Studentët nxiten për t'u përfshirë, eksploruar dhe dialoguar me të tjerët gjatë procesit të zhvillimit të kuptuarit se ç'do të thotë të jesh ndërkulturore. Shembuj nga jeta reale do të sillen për shqyrtim e diskutim në klasë. Synohet po ashtu rritja e ndërgjegjësimin për përmasat konjitive, afektive dhe sjellimore të kompetencës ndërkulturore dhe cilësitë që lidhen me qytetarinë globale.

g. **ITA454 -Kulturë dhe qytetërim i vendeve italianofone- Ngarkesa: 4 kredite, 2 leksione dhe 1 seminar në javë.** Kultura dhe Qytetërimi i vendeve italianofone ka për qëllim të njohi studentët me zhvillimin e kulturës gjuhësore dhe qytetërimit të vendeve italianofone ndër vite. Ky kurs ka për qëllim të pajisë studentët me njohuritë bazë të zhvillimeve shoqërore, jetën politike, ekonomike dhe kulturore të këtyre vendeve dhe rolin e gjuhës në këtë këndvështrim. Studentët do të prezantohet me konceptet, traditat dhe perspektivat në fushën e zhvillimit gjuhësor- kulturor. Si mësues të ardhshëm të gjuhës italiane studentët do të njihen me format e fundit të metodologjisë së mësimdhënies duke pasur parasysh rëndësinë e të mësuarit të gjuhës nëpërmjet kulturës dhe anasjelltas, duke futur dhe duke e bërë atë si një pjesë thelbësore të mësimin të gjuhës italiane dhe të nxënës. Studimet kulturore kanë parë zhvillime të mëdha gjatë shekullit të kaluar dhe këtij shekulli. Kjo lëndë kontribuon në zhvillimin e vlerave shoqërore që kanë të bëjnë me barazinë gjinore, demokracisë dhe sigurisht zhvillimet e ndryshimet gjuhësore dhe kulturore.

h. **ITA 455-Didaktikë e gjuhës italiane-** Moduli 1: Didaktikë e gjuhës italiane Moduli 2: Qasje profesionale ndaj didaktikës së gjuhës italiane. **Ngarkesa: 8 kredite, (4+4) / 2 leksione dhe 1 seminar në javë.** Didaktikë e gjuhës italiane është një disiplinë e formuar dhe e konsoliduar gradualisht, me një objekt studimi të përcaktuar qartë me aktorët e saj dhe instrumentet e veprimit, siç janë: tekstet shkollore dhe formimi i mësuesve në nivele të ndryshme. Ky kurs i shtrirë në dy module: (Moduli 1: ITA 455-1 Didaktikë e gjuhës italiane dhe Moduli 2: ITA 455-2 Qasje profesionale ndaj didaktikës së gjuhës italiane) synon t'u përgjigjet pyetjeve mbi natyrën e procesit të mësimin të gjuhës angleze, mbi metodat e shumëllojshmërinë e teknikave më të përshtatshme të përvetësimit të aftësisë së komunikimit, mbi mësimin e gramatikës, të leksikut, të shprehjeve, të kompetencave, llojet e veprimtarive praktike që do të mbështesin procesin mësimor dhe do të rrisin autonominë e të nxënës, vlerësimin dhe vetëvlerësimin. Studentët do të jenë të aftë të hartojnë dhe shkruajnë plane mësimore, duke i konkretizuar në një "classroom setting" të stimuluar, të reflektojnë mbi eksperiencat personale mësimdhënëse e mësimnxënëse, si edhe të bëjnë krahasimin me metodat e diskutuara në klasë. Didaktika konsiderohet si një kryqëzim ku të gjitha kalimet janë të mundshme dhe në të cilin metodologjia përbën sheshin qendror ku mund të takohen të gjithë: didaktët, mësuesit, nxënësit, hartuesit e programeve, hartuesit e teksteve, formatorët etj.

i. **ITA 456 - Didaktikë e letërsisë dhe kulturës - Ngarkesa: 4 kredite, 2 leksione dhe 1 seminar në javë.** Kursi 'Didaktikë e letërsisë dhe kulturës' ka një fokus të dyfishtë: nga njëra anë, synon të aftësojë studentin të analizojë dhe shqyrtojë tekste nga gjini të ndryshme dhe nga ana tjetër, që t'i përdorë këto tekste në klasë. Synon të stimulojë analizën individuale të teksteve letrare për të rinjtë, për shembull përmes përdorimit të shkrimit krijues në gjini të ndryshme dhe sipas metodave dhe teorive të ndryshme. Për më tepër, kursi synon të bëjë studentin të thellohet



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

për kulturën, shoqërinë dhe letërsinë e vendeve anglishtfolëse përpos të kuptuarit qartazi të lidhjes që bart historia. Njohja e letërsisë dhe sesi mund të përshtatet për përdorim në klasë do të vihet në pah. Toleranca dhe të kuptuarit ndërkombëtar janë vlera të integruara në punën me tekste dhe çështje të ndryshme, edhe në shkollën fillore.

j. **ITA 458 – Sociolinguistikë- Ngarkesa: 3 kredite, 2 leksione dhe 1 seminar në javë.** Në këtë kurs, sociolinguistika mësohet si një degë e gjuhësisë që studion gjuhën në raport me shoqërinë. Objektivi kryesor i sociolinguistikës është të shpjegojë se si variacionet linguistike të folësve (p.sh. sjelljet e tyre të ndryshueshme gjuhësore) janë të lidhura me variacionin në karakteristikat sociale të folësve (dmth prejardhja e tyre sociale). Qëllimi i studimit të sociolinguistikës është për të arritur një përparim të mëtijshëm në njohjen e natyrës dhe funksionin e gjuhës njerëzore nga ana e studimit të gjuhës në kontekstin e saj social. Variant i saj është rezultat i faktorëve të ndryshëm si: fcaja, mosha, përkatësia etnike, gjinia, etj. Ajo tregon se kombinimi i këtyre komponentëve mbart ndikim në përvetësimin dhe përdorimin e gjuhës.

k. **ITA 461-Linguistikë e aplikuar- Ngarkesa: 3 kredite, 2 leksione dhe 1 seminar në javë .** Kursi "Linguistikë e aplikuar" është një kurs hyrës, i cili synon t'i pajisë studentët që ndjekin këtë program studimi me njohuri të përmbledhura rreth bazave teorike të mësimdhënies dhe mësimnxënies së gjuhës, të kuptuarit të gjuhës si sistem, në mënyrë të tillë që studentët jo vetëm të marrin njohuri të vlefshme rreth kësaj fushe tejet përfshirëse, por edhe t'i kuptojnë dhe zbatojnë këto njohuri gjatë proceseve të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Studentët do të kenë rritur të kuptuarit e gjuhës si system, duke përfshirë fonologjinë, morfologjinë, sintaksën, semantikën dhe pragmatikën, do të jenë në gjendje t'i zbatojnë këto njohuri në mbështetje të përvetësimit të shprehive gjuhësore të dëgjimit, shkrimit, leximit, të folurit, do të dallojnë midis zhvillimit të shkrimit e këndimit në gjuhën e parë dhe në gjuhën e dytë dhe sesi këto ndikojnë tek njëra-tjetra, do të kuptojnë variablat sociokulturore, sociopolitike dhe psikologjike që ndikojnë në përvetësimin e gjuhës së huaj.

l. **ITA 462- TIK në mësimdhënien e gjuhës së huaj- Ngarkesa: 3kredite / 2 orë në javë, 1 leksion dhe 1 seminar** Komunikimi dhe Teknologjia e Informacionit po pësojnë zhvillim të shpejtë dhe evoluim të vazhdueshëm. Zbatimi i teknologjive në arsim dhe trajnim përfshijnë përparësi që ofrojnë të mësuar në një ambient stimulues dhe të pasur, mbështetur nga një kombinim i burimeve multimediale. Ekziston një mori informacioni në literaturë, për mënyrën se si TIK mund të përdoret për t'i ofruar mësimdhënies dhe të nxënit mbështetje, andaj konsiderohet si "*Kopshti i Edenit*" nëse integrohet me sukses në klasat e gjuhëve të huaja. Ky është edhe qëllimi primar i lëndës ENG.462. *Pozicionimi i teknologjisë brenda orës së mësimt* e shndërron atë në një pjesë të natyrshme të klasës sikurse dhe mjetet e traditës si teksti, fjalori, gjuha apo lapsi dhe fletorja. Tempi i ndryshimit s'mund të jetë i njëtrajtshëm për grupe të ndryshme mësuesish. Disa mund t'i përqafojnë më shpejt shprehitë e reja, të tjerë mund të mbeten indiferentë ndaj risive teknologjike, por një gjë është e sigurtë, që teknologjia do të vazhdojë të depërtojë në të gjitha nivelet e mësimdhënies së gjuhëve të huaja. Për këtë, mësuesit kanë nevojë të inkurajohen të integrojnë *blog-un*, *chat-in* krahas mjeteve të tjera për të mos e kthyer mësimdhënien në një ishull të shkëputur nga realitetet e jetës së përditshme.

Në këtë kuadër, modelet dhe përvojat e pasura teknologjike e pedagogjike të kolegëve të huaj që kontribuojnë në vendin tonë, përbëjnë një vlerë dhe një shtesë për mësuesit tanë për arritje të dobishme në një kohë sa më të shkurtër. Çështja e integritetit të TIK në mësimdhënien e gjuhëve, përbën një problem të kohës edhe në Evropë, por në vendin tonë sfidat janë edhe më të mëdha për shkak të nevojës për ndërgjegjësim të mësuesve e nxënësve, e nevojës për mbështetje



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

infrastrukturore e trajnime kualifikuese sistematike të tyre. Çdo ditë e më shumë mësuesit janë duke investuar për t'u pajisur me shprehitë e nevojshme për të vënë në shfrytëzim përparësitë e tekologjisë në punën e tyre, që nga mësuesit që krijojnë materiale mësimore në *Word*, e deri tek përdoruesit e përkushtuar, anëtarë të bashkësive *online*.

m. **ITA 463- Mësimdhënie e gjuhës së huaj në/për kontekste evropiane-** Moduli 1: Politikat evropiane për gjuhën/Moduli 2: Kuadri evropian i kompetencave gjuhësore/Moduli 3: Ndërkulturalizmi, multilinguizmi dhe plurilinguizmi. **Ngarkesa:** 6 kredite (moduli 1: 1.5 kredite; moduli 2: 2 kredite; moduli 3: 2.5 kredite), 4 seminar në javë. Kursi 'Mësimdhënie e gjuhës së huaj në/për kontekste evropiane' është konceptuar si një kurs hyrës për studentët e këtij programi, të cilët njihen për herë të parë me këtë lëndë. Kursi, i ndarë në tre module, do të trajtojë çështje që kanë të bëjnë me politikat evropiane të gjuhës dhe mësimdhënies së gjuhës së huaj, zbatimin e tyre, kuadrin evropian të gjuhëve, çështje të multilinguizmit, plurilinguizmit, ndërkulturalizmit etj. Ky kurs do t'i aftësojë studentët që të zhvillojnë kompetencën për leadership gjuhësor, të njohin politikat evropiane të gjuhës, të njohin dokumentacionin, dmth, ligjet, rregullat, kurrikulat etj që lidhen me politikat evropiane gjuhësore, të lidhin kuadrin evropian ligjor të gjuhës me atë kombëtar, të kuptojnë profilin evropian të mësuesit.

n. **ITA 470- Kërkim në edukim-** Moduli 1: Metodot e kërkimit /Moduli 2: Shkrim propozimesh dhe raportesh kërkimore. **Ngarkesa:** 8 kredite (4 kredite për modul); 2 leksione dhe 1 seminar në javë (moduli 1), 1 leksion dhe 2 seminare në javë (moduli 2). ITA 470 Kërkim në edukim - Kursi synon t'u bëjë një hyrje studentëve të nivelit MP në mësimdhënie në gjuhë angleze me drejtim minor në gjuhë italiane për metodat e kërkimit në edukim. Kursi është i konceptuar i ndarë në dy module, i pari teorik dhe i dyti praktik. Moduli i parë i njeh studentët me disa nga konceptet bazë të zbatuara në kërkimin në edukim, tipet e ndryshme të metodave të përdorura, avantazhet dhe disavantazhet e secilës dhe, mbi të gjitha, synon t'i përgatisë sesi të kryejnë kërkim. Moduli i dytë ka natyrë praktike dhe vë në zbatim të gjitha njohuritë e marra në modulin e parë përmes punëve dhe detyrave të ndryshme kërkimore që u kërkohen studentëve të kryejnë. Ky kurs do t'i aftësojë studentët që të: 1. të identifikojnë modellet kërkimore duke gjykuar mbi avantazhet dhe disavantazhet e tyre, mjetet dhe teknikat kërkimore e përdorura në secilën, procedurat për mbledhjen dhe analizën e të dhënave etj. 2. të formulojnë pyetje të qarta dhe të mundshme për të bërë kërkim dhe për të pohuar një problem kërkimor. 3. të kryejnë përmbledhje të literaturës me qëllim që të kuptojnë rëndësinë e pyetjeve kërkimore si dhe të identifikojnë hapësira në literaturë. 4. të përgatisim një projekt-propozim përmes koncepteve teorike dhe praktike. 5. të zgjedhin modelin kërkimor të duhur për kërkim. 6. të zgjedhin mjetet e duhura për analizën e të dhënave. 7. të përcaktojnë vlefshmërinë dhe besueshmërinë. 8. të kumtojnë hipotezën e duhur për një problem kërkimor. 9. të përcaktojnë se çfarë mund të konkludohet nga një punë kërkimore.

o. **ITA 490- Praktikë mësimore - Ngarkesa:** 9 kredite, 6 javë

Në zbatim të kërkesave të planit mësimor, studentët e përfshirë në programin "Master profesional në mësuesi për ciklin e lartë të arsimit bazë në lëndën gjuhë italiane" do të kryejnë praktikën pedagogjike aktive në shkollat 9-vjeçare (e të mesme). Kursi përmban 9 kredite, të konvertuara në 300 orë. Praktika pedagogjike ka për qëllim të aftësojë studentët nga pikëpamja profesionale për të dhënë mësim, në përputhje me kërkesat bashkëkohore që shtrihen sot për forcimin cilësor të shkollës, dhe për t'i aftësuar me shpreh praktikë për shkollën dhe jetën. *Veprimtari të kërkuara nga studentët:* Kandidati të zhvillojë orë mësimi me nivel të mirë, duke u përgatitur seriozisht e me përgjegjësi për orën e mësimi, nga ana shkencore dhe pedagogjike-



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

metodike. Të realizojë, në lidhje organike, të gjitha momentet e orës së mësimi, në bazë të hartimit të plankonspektit të detajuar, duke i kushtuar kujdes realizimit të të gjitha objektivave pedagogjike. Kandidati të përdorë pyetje logjike, argumentime, interpretime, analiza, krahasime, përfundime dhe të nxjerrë konkluzione për dukuritë, ngjarjet e faktet që analizon. Në tërë procesin e punës të udhëhiqet nga përvoja bashkëkohore përëndimore që shprehet në literaturën metodike që qarkullon sot si "Të mësuarit me objektiva". Të krijojë situata problemore në orët e mësimi, duke lidhur natyrshëm punën e mësuesit me atë të nxënësit në orën e mësimi, me një veprimtari të gjallë e efektive. Të aftësojë nxënësit për zgjidhjen e detyrave të pavarura në klasë e në shtëpi në mënyrë krijuese, kundër riprodhimit mekanik.

p. **FRE 431 - Frëngjisht (Frëngjisht 1, Frëngjisht 2)- Ngarkesa: 4 kredite për modul, 8 kredite gjithsej, 3 orë në javë (1 leksion dhe 2 seminare).** Ky kurs u ofrohet studentëve që kanë përvetësuar tashmë nivelin B1 të gjuhës frënge në dy module dhe synon asimilimin në nivel mbimesatar dhe të përparuar të katër kompetencave: të kuptuarit me gojë e me shkrim, të shprehurit me gojë e me shkrim. Ky kurs lejon paraqitjen në nivelin DELF B2 sipas Kuadrit të Përbashkët Evropian të Referencave për Gjuhët e Huaja. Ky kurs ofron jo vetëm njohuri gjuhësore, por edhe njohuri për historinë e kulturën franceze. Kursi favorizon përfshirjen e studentëve në të nxënësit e tyre me qëllim që t'i bëjë ata aktivë në përvetësimin e gjuhës. Ky program ndjek itinerarin e një jete, origjinën, hapësirat e jetës, lidhjen me zakonet kulturore deri në hapjen drejt botës. Kursi synon një ecuri që shkon nga të kuptuarit deri tek të shprehurit.

q. **FRE 454 - Kulturë dhe qytetërim francez - Moduli 1: Kulturë frënge / Moduli 2: Qytetërim francez. Ngarkesa: 4 kredite për modul, 8 kredite gjithsej, 3 orë në javë (1 leksion dhe 2 seminare)** Ky kurs i qytetërimit dhe kulturës franceze bën një paraqitje të zhvillimeve historike, kulturore, sociale, letrare dhe artistike të Francës dhe botës frëngjishtfolëse. Kursi është i konceptuar i ndarë në dy module dhe synon të japë njohuri hyrëse për botën frankofone. Do të prezantohen tekste të shkurtër letrarë, në poezi apo prozë. Për studimin e territorit dhe gjeografisë, artit do të merren në shqyrtim pjesë për të dëgjuar, si dhe do të përdoren harta. Teksti bazë është i ndarë në pesë pjesë. Përvetësimi i njohurive dhe të kuptuarit e zhvillimeve të fundit në fushën e konceptit gjuhë-kulturë. Studimi i fakteve të rëndësishme të kulturës dhe qytetërimit francez brenda dhe jashtë Francës. Vlerësimi i vlerave dhe ndikimin e tyre në atë që shoqëria quan si shumë të rëndësishme të tilla si gjinia, raca, përkatësia etnike, fesë, qeverinë, arsimin, jetën sociale dhe familjare. Zhvillimi i studimeve gjuhësore-kulturore dhe qytetërimit.

r. **GER 431 - Gjermanisht - Gjermanisht 1, Gjermanisht 2. Ngarkesa: 4 kredite për modul, 8 kredite gjithsej, 3 orë në javë (1 leksion dhe 2 seminare).** Ky kurs u ofrohet studentëve që kanë përvetësuar tashmë nivelin B1 të gjuhës gjermane, në dy module, dhe synon asimilimin në nivel mbimesatar dhe të përparuar të katër kompetencave: të kuptuarit me gojë e me shkrim, të shprehurit me gojë e me shkrim. Ky kurs lejon paraqitjen në nivelin B2 sipas Kuadrit të Përbashkët Evropian të Referencave për Gjuhët e Huaja. Ky kurs ofron jo vetëm njohuri gjuhësore, por edhe njohuri për historinë e kulturën gjermane. Kursi synon përfshirjen e studentëve në të nxënësit e tyre me qëllim që t'i bëjë ata aktivë në përvetësimin e gjuhës. Ky program ndjek itinerarin e një jete, origjinën, hapësirat e jetës, lidhjen me zakonet kulturore deri në hapjen drejt botës. Kursi synon një ecuri që shkon nga të kuptuarit deri tek të shprehurit. Synohet që në fund të këtij programi, studentët: a) të kenë një bazë të konsiderueshme të strukturave të përparura të gjuhës gjermane, b) të fitojnë një fjalor të mjaftueshëm për të komunikuar në situatat e jetës së përditshme si dhe një njohje të fjalorit aktiv plotësues, c) të jenë të aftë të kuptojnë gjermanishten e folur me një shpejtësi mbimesatare/të përparuar në



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

bisedë, d) të jenë të aftë të shprehin veten me shkrim në një tekst të nivelit të përparuar, e) të jenë të aftë të lexojnë tekste të ndryshme të nivelit mbimesatar/të përparuar në gjermanisht, f) të asimilojnë shkathtësitë e komunikimit ndërpersonal, qoftë në shqip, qoftë në gjermanisht, g) të rrisin ndërgjegjësimin dhe vlerësimin e tyre për gjermanishtfolësit dhe për kulturën e tyre, h) të shprehin në mënyrë të qartë dhe të hollësishme mbi një gamë të gjerë temash.

